

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7749 E martë 25 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Pas dhjetë vjetësh pavarësi, Kosova rikrijoi ushtrinë e vet. Këtë herë të paqes. Edhe kjo lëvizje e popullit shqiptar u lexua si e rrezikshme. Siç kanë qenë lexuar ...
Vijon në faqen 20

Nga ZENO JAJAJ

"Rreziku" nga Ushtria e Kosovës



Dje **në** "New York Times"

Për një evropian, vizita në Shteteve të Bashkuara këto ditë i ngjan paksa shkuarjes tek dentisti: dhëmbët janë të sëmurë, aroma juaj e gojës është problematike ...
Vijon në faqen 21

Nga IVAN KRASDEV

Si do të jetë bota pas Trump-it?



Prapaskenat e mbledhjes 6 orë në PS
Ndryshimet në qeveri? Rama: Po lexoj mesazhin e studentëve

Të premten asambleja, paralajmërohen surpriza. Kryeministri: Vetëkorrigjohemi

Kryeministri Edi Rama nuk e ka përjashtuar mundësinë e ndryshimeve në kabinetin qeveritar: ndonëse gjatë mbledhjes së kryesisë së Partisë Socialiste nuk u diskutua fare për to. Duke folur fill pas mbledhjes së kryesisë, i pyetur nga gazetarët për ndryshimet në qeveri, Rama nuk i mohoi ato, por duke bërë të ditur se çdo vendim do merret ...
Në faqen 3

HYN NE FUQI VENDIMI I QEVERISE, 3 MIJE LEKE PER SHITRESAT NE NEVOJE

SHPERBLIMET E FUNDVITIT, 4 KATEGORITE PERFITUESË

Fondi financiar 400 milionë lekë të reja shpërndahet për familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, të verbrit dhe personat me aftësi të kufizuar



(Në foto) Kryeministri Rama duke dalë nga mbledhja e kryesisë së PS, dje në Tiranë

Në faqen 11

PRETENCA

Para dhe prona nga prostitucioni, 15 vite burg për çiftin nga Shijaku

Në faqen 7

GUVERNATORI

Gent Sejko i BSH: Rënia e prodhimit të energjisë ka frenuar ekonominë

Në faqen 9

RREGULLAT E REJA

Emigrantët pa leje qëndrimi në Greqi, si do bëhet lëvizja në kthim

Në faqen 10

ARTET PAMORE

Galeria e Arteve: E mbyllëm "Onufrin" sepse kishte humbur nivelin

Në faqen 18

INTERVISTA NE "NEWS 24"



Berisha: Rama ikën me revoltë. Rikthim në krye të PD? S'jam Napoleon

Në faqen 4

Projektvendimi i KQZ/ Shpërblimi për anëtarët e komisioneve, 60 mijë lekë

Zgjedhjet, sa do paguhen 42 mijë komisionerë

Anëtarët e qendrave të votimit do të përfitojnë 40 mijë lekë të reja

Ndërsa partitë politike nuk kanë arritur ende të gjejnë konsensusin dhe miratojnë ndryshimet zgjedhore që do të depolitizojnë komisionet e administrimit të zgjedhjeve, KQZ në përmbushje edhe të detyrimeve të saj ligjore, ka vendosur që t'i organizojë zgjedhjet me



Kodin e vjetër Zgjedhor. Për rrjedhojë edhe komisionet zgjedhore në nivel KZAZ-je dhe KQV-je do jenë me përbërje politike dhe me nga 7 anëtarë. Për secilin për tyre, ashtu si edhe në zgjedhjet e shkuara vendore do të ketë një masë shpërblimi, kjo në ...

Në faqen 5

UNAZA E MADHE AFERA


Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje të tjera dokumente për çështjen e planit urbanistik të Tiranës, duke ngulmuar se plani u ndryshua për të favorizuar një projekt të biznesmenit Edmond Bego. PD përmes deputetes Jorida Tabaku dhe zëdhënësës Ina Zhupa akuzoi se përveç kryeministrit Rama dhe kryebashkiakut Veliaj, i përfshirë në këtë aferë është edhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Sipas PD-së, përveç përmblylljes në një kohë rekord të privatizimit dhe shitjes së ish-serave pranë Unazës së Madhe, ministri Ahmetaj ka pasur marrëdhënie direkte financiare me Edmond Begon për këtë pronë. Zj.Tabaku akuzoi se Veliaj është përgjegjës me firmën e tij për ndryshimin e planit urbanistik të Tiranës. "Sipas planit të 2013-ës, lumi Lanë zinte një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës, ku Bego ka planifikuar të ndërtojë. Por, plani u ndryshua në 2017-ën, pasi Bego kishte lidhur kontratë për ndërtimin e projektit 60 milionë euro. Me firmën e Erion Veliajt dhe të Edi Ramës, plani ndryshoi dhe Lumi Lana u zhvendos duke mos prekur asnjë centimetër nga toka ku do të ndërtojë trafikanti i drogës, miku i Taulant Ballës. Gjatë gjithë këtyre ditëve, Veliaj që flet për gjithçka, nuk u ka shpjeguar shqiptarëve pse e ndryshoi projektin e Lanës për llogari të projektit 60 milionë euro të Edmond Begos. Kush fshihet pas trafikantit ndërkombëtar të drogës, i cili ka deklaruar publikisht se nuk disponon 60 milionë euro? Këtyre pyetjeve duhet t'u japë përgjigje edhe ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Ai është personi i dytë kyç në këtë aferë", tha Tabaku. Deputetja e PD akuzoi ministrin Arben Ahmetaj, pasi sipas saj, mashtrori qytetarë kur tha se ministria e drejtohet prej tij nuk ka pasur asnjë lidhje me Edmond Begon gjatë procesit të privatizimit të zonës, ku i dënuari me 21 vjet burg për trafik droge do të ndërtojë projektin rezidencial 60 milionë euro. "Ndryshe nga sa mashtron Arben Ahmetaj, dokumentet zyrtare provojnë se shitja është kryer për llogari të mikut trafikant drogë të Taulant Ballës", deklaroi Tabaku. Kurse zëdhënësja e PD, Ina Zhupa, bëri të ditur se afëra e ka pikënisjen tek ministria e Financave dhe Ekonomisë, Edmond Bego është personi që ka paguar rreth 1.5 milionë euro në llogarinë e Min-

PD nxjerr dokumentet: Bego ia bleu ministrit 1.5 mln euro ish-serat tek Unaza e Madhe

Unaza, PD: Firma e ministrit Ahmetaj, në privatizimin e serave

"Pagesat, nga kompania 'Inerte Ekspres'"



Dokumentet e publikuara dje nga PD

AFERA

"Kush fshihet pas trafikantit ndërkombëtar të drogës, i cili ka deklaruar publikisht se nuk disponon 60 milionë euro? Këtyre pyetjeve duhet t'u japë përgjigje edhe ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Ai është personi i dytë kyç në këtë aferë", tha deputetja Tabaku.

Kryeministri Edi Rama dje pas mbledhjes së kryesisë së PS-së



Akuzat e PD-së për Unazën e Re dhe Begon

MF: Fitues i ish-serës s'është Bego, por trashëgimtarët e Pinarit

Ministria e Financave iu përgjigj dje akuzave të PD-së për privatizimin e zonës së ish-serave për shtetas Edmond Bego, që sipas opozitës është i lidhur me trafikun e drogës dhe ka lidhje të afërta me Taulant Ballën. Endrit Duka, drejtor në Drejtorinë e Drejtim-it të Pronës Publike në Ministrinë e Financave, teksa i konsideroi të pabaza akuzat e opozitës, sqaroi hapat e privatizimit të pronës në fjalë. Ai theksoi se në asnjë rast Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka lidhur asnjë kontratë shitjeje dhe as privatizimi me herët me personin me emrin Edmond Bego. "Sikurse duket qartë në këtë dokument, Ministria e Financave autorizon kalimin e objek-



teve 'sera dhe magazina' në pronësi të trashëgimtarëve të objekteve të shpronësuar Maliq dhe Hamdi Pinarit, si fitues të së drejtës së privatizimit të objekteve me vlerë filltare me të drejtën e parblerjes si pronar truall si dhe autorizon kryerjen e pagesës në llogari të MF brenda afatit të përcaktuar në ligj prej 30 ditësh. Futura e bankës konfirmoi se në llogarinë e MF është dërdhur pagesa në fjalë

REAGIMI

"Ministria e Financave ka favorizuar kalimin e serave në pronësi të trashëgimtarëve Hamdi Pinarit. PAGESA është kryer nga trashëgimtarët Pinarit", deklaroi z.Duka.

në emër të trashëgimtarëve Pinarit nga një entitet privat me emër "Inerte Ekspres" shpk, e cila është procedurë e rregullit bankare, që rregullon një marrëdhënie private mes dy palëve dhe nuk implicon në këtë rast Ministrinë e Financave as e bën përfutues nga kontrata e shitjes, personi i cili ka depozituar paratë në bankë", deklaroi z. Duka.

PD: Rama u merr shtëpitë qytetarëve që t'u lajë borxhet kriminelëve

Banorët e Unazës së Re protestuan sërish mbremë kundër projektit të Unazës së Madhe. Pavarësisht se festat e fundvitit janë pranë, ata nuk tërhiqen nga qëndresa e tyre. Një nga banorët e kësaj zone nga protesta, ndërsa uron shqiptarët, shprehet se Krishtlindjet e tij dhe të gjithë Unazës janë plagosur për këtë vit. "Urojme një vit sa më të mbarë, pavarësisht se për ne, banorët e Unazës së Re, Krishtlindjet janë të plagosura. Faleminderit edhe për ju mediat që na keni mbështetur!", u shpreh ai. Për rreth 2 muajsh në formë qëndrese, banorët e Unazës mbledhen çdo darë për të ngritur zërin kundër këtij projekti dhe për të deklaruar se nuk do të lejojnë prishjen e banesave të tyre. Edhe në ditën e 52 të protestës banorët e Unazës së Re vazhdojnë të kenë mbështetjen e deputetëve të opozitës. Deputeti i PD-së, Klevis Balliu, nga protesta e banorëve të Unazës së Re akuzoi se Rama po kërkon t'u marrë shtëpitë qytetarëve për të larë borxhet që i ka kriminelëve të kriminelëve. "Ky kryeministër po kërkon t'u marrë shtëpitë qytetarëve për t'u larë borxhet që u ka kriminelëve si Edmond Bego. Këta banorë këtu janë heronj, u kanë shpëtuar shqiptarëve 40 milionë euro", deklaroi Balliu.



mikut të Taulant Ballës dhe se nëpërmjet saj, janë bërë 4 pagesa për llogari të Ministrisë së Financave përpara se ajo të lidhte kontratën e privatizimit. Arben Ahmetaj mund të nxjerrë arkivin e Ministrisë së Financave që nga krijimi i saj, por nuk mund të fshehtë dot faktin se ai e privatizoi

pronën vetëm pasi trafikanti i drogës mori përsipër të mbyllte procedurën e privatizimit. A ka pjesë Arben Ahmetaj në projektin rezidencial 60 milionë euro që zhvendosi Lanën me firmën e Ramës dhe Veliajt? Përgjigje për këtë pyetje është vetëm çështje kohe", - shprehet PD.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjës e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Lika Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 e-mail: marketing@gazetashiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrafikëve, Tiranë - Tel: (04) 2359-104 Tel&Fax: (04) 2359-116 Marketingu: Tel: (04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



Kryeministri ka paralajmëruar lëvizje në kabinet gjatë mbledhjes së asamblesë

Ndryshimet në qeveri? Rama: Po lexoj mesazhin që na dhanë studentët

Kryesia e PS-së ka diskutuar 6 orë mbi nevojën për reflektim

Kryeministri Edi Rama nuk e ka përjashtuar mundësinë e ndryshimeve në kabinetin qeveritar, ndonëse gjatë mbledhjes së kryesisë së Partisë Socialiste nuk u diskutuar fare për to. Duke folur fill pas mbledhjes së kryesisë, i pyetur nga gazetarët për ndryshimet në qeveri, Rama nuk i mohoi ato, por duke bërë të ditur se çdo vendim do merret hap pas hapi. Ndërkohë që kryesia e PS-së në 6 orë mbledhje diskutoi gjatë mbi situatën e krijuar nga protesta e studentëve dhe nevojën për një reflektim të menjëhershëm, ndërsa vendosi përcaktotje edhe axhendën për Asamblenë Kombëtare që do të mbledhet të premtën, ku kryeministri lajmëroi se do të ketë lajme edhe në drejtim të ndryshimeve në qeveri.



Mbledhja e kryesisë së PS-së

QEVERIA
"Çdo gjë hap pas hapi. Ju e dini që unë nuk e them asnjëherë fjalën e fundit të parën. Unë di gjithmonë radhën e lëvizjeve, pasi gjithmonë mendohej gjatë përpara se sa të bëj çdo lëvizje. Ne do të bëjmë të gjitha gjërat e duhura dhe do t'i përgjigjemi me dinjitet shqetësimit të studentëve".

ÇËSHTJET DHE VENDIMET E KRYESISË

- Miratimi i raporteve mbi situatën dhe organizimin e partisë në bazë.
- Diskutimi dhe analizimi i performancës së kryetarëve të bashkive dhe këshilltarëve bashkiakë.
- Analizimi i punës së bërë gjatë procesit të llogaridhënies me qytetarët.
- Analizimi dhe përmirësimi i mekanizmave të komunikimit në raport me shoqërinë.
- Diskutimi dhe analizimi i shkaqeve që sollën protestën e studentëve.
- Reflektimi dhe marrja masave për të korrigjuar gjithçka negative që nxori protesta e studentëve në raport me qeverisjen.
- Diskutimi i rolit të forumeve të Partisë Socialiste, si FRESH dhe Forumi i Gruas Socialiste gjatë protestës dhe nevoja për të reflektuar.
- Thirrja e mbledhjes së Asamblesë Kombëtare dhe miratimi i axhendës së saj.
- Thirrja në datë 30 mars e Kongresit Zgjedhor të PS-së.

KRYESIA

Ashtu siç edhe ishte vendosur më parë, mbledhja e kryesisë nisi në orën 9 dhe në të merrnin pjesë thuajse të gjithë anëtarët e saj. Ajo u drejtua nga kryetari i PS-së, Edi Rama, ndërsa në një pjesë të mirë të kohës ajo iu kushtua pikërisht raportimeve të detajuar të krerëve të qarqeve lidhur me situatën e partisë në rrethe dhe përgatitjet elektorale për zgjedhjet e ardhshme vendore. Për shkak të një raportimi të detajuar, kjo pikë e rendit të ditës së kryesisë ka marrë dhe një kohë mjaft të gjatë. Gjithashtu, të deleguarit e kryesisë në drejtimin e qarqeve kanë bërë një analizë të thellë edhe të performancës së kryetarëve të bashkive dhe këshilltarëve të PS në bashkitë përkatëse. Kjo edhe për të përcaktuar hapat që do të hedhë më tej PS në përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë. Një tjetër pikë e rëndësishme e kësaj mbledhjeje mësohet se ishte edhe analiza e situatës dhe nxjerrja e mësimeve konkrete nga protesta e studentëve. Rama ashtu siç edhe ka bërë të ditur edhe publikisht, mësohet se ka deklaruar se protesta e studentëve ishte një shuplakë nga e cila duhet të dilnin mësimet konkrete për çdo ministri dhe për çdo socialistë që mban një detyrë në institucionet shtetërore. Rama ka kërkuar një reflektim të thellë dhe për të nxjerrë përgjegjësi për situatën e krijuar. Një tjetër çështje e diskutuar në kuadër edhe të

PS mbledh të premtën asamblenë, Rama paralajmëron surpriza

Partia Socialiste do të mbajë të premtën, vetëm 3 ditë para Vitit të Ri, mbledhjen e Asamblesë Kombëtare. Mbledhja pritet me kureshtje jo vetëm nga anëtarët e PS-së, por edhe nga anëtarët e kabinetit qeveritar, për shkak se në të pritet të bëhen edhe lëvizjet e paralajmëruara në kabinetin qeveritar. Këtë e la të kuptohet dhe vetë kryeministri Edi Rama, i cili tha se do të flasim prapë për ndryshimet qeveritare gjatë mbledhjes së asamblesë. Do të mbledhim Asamblenë Kombëtare dhe do të flasim përsëri", deklaroi Rama dje pas mbledhjes së kryesisë së PS-së. Ai pritet të mbajë një fjalë të gjatë para anëtarëve të asamblesë, ku përveç analizës së situatës aktuale, pritet të bëjë ditur edhe vendimet e tija për ndryshimet qeveritare. Gjithsesi, burime nga PS kanë bërë të ditur se gjatë kësaj mbledhjeje Rama mund të deklarojë vetëm nevojën e ndryshimeve në kabinet, ndërsa mund t'i shpallë ato vetëm në fillim ose nga mesi i janarit. Kjo për shkak se në rast se do t'i shpallë të premtën, atëherë ministrat e rinj duhet të presin afro 1 muaj për të marrë detyrën. Kujtojmë se aktualisht Kuvendi është pushim dhe sesioni i ri parlamentar mbledhet vetëm të hënën e tretë të janarit, ku dhe duhet të miratojë ministrat e rinj. Ndaj për të mos lënë ministrat që do të kenë lëvizje pa ministra, ai mund të shtyjë këtë vendim rreth mesit të muajit të ardhshëm.



masave që duhen marrë pas protestës së studentëve është edhe reformimi total i forumeve partiake, siç është edhe FRESH. Burime nga mbledhja kanë bërë të ditur se Rama ka qenë kritik rreth rolit dhe performancës që luan ky forum, ndërsa ka theksuar se protesta nxori në pah inezkactencën e tij. Sipas tij, asnjë nga kjo organizatë nuk kishte arritur të evidentonte problematikën

dhe mlllefin me të cilin ishin ngarkuar studentët nëpër universitete. Ndërkohë që kryesia ka diskutuar edhe për të thirrur kongresin elektor të PS-së në fund të muajit mars, ku pritet të bëhen edhe zyrtarizimi i kandidatëve për kryetar bashkie si dhe të përcaktohet strategjia dhe sloganit elektor. Burime nga mbledhja kanë bërë të ditur se ndonëse Rama ka folur për

nevojën e reflektimit dhe vetëkorrigjimit, nuk ka përmendur për asnjë moment gjatë kësaj mbledhjeje ndryshimet në qeveri. Të njëjtat burime kanë bërë me dije se Rama ka qenë i qetë gjatë mbledhjes, ndërsa nuk i ka kursyer kritikant në përgjithësi për situatën në të cilën ndodhet partia dhe qeveria.

RAMA

Në një prononcim për mediat pas mbledhjes së kryesisë, kryeministri Rama e ka lënë të hapur mundësinë e ndryshimeve në qeveri, por sipas tij çdo vendim do merret në kohën e duhur dhe në vendin e duhur. "Çdo gjë hap pas hapi. Ju e dini që unë nuk e them asnjëherë fjalën e fundit të parën. Nga ana tjetër, unë di gjithmonë radhën e lëvizjeve, pasi gjithmonë mendohej gjatë përpara se sa të bëj çdo lëvizje. Ne do të bëjmë të gjitha gjërat e duhura dhe do t'i përgjigjemi me dinjitet shqetësimit të studentëve", - tha Rama. Ai shtoi se pavarësisht punës që është bërë, njerëzit meritojnë akoma më shumë. "Kemi bërë gabimet tona. Gabime që i bëjnë të gjithë ata që ndërtojnë, punojnë dhe që përpiqen të sposton nga dikë në dikë tjetër dhe të marrin përsipër sfidat si sfidat që ne kemi marrë përsipër, por e rëndësishme është që të mësojmë prej gabimeve dhe të shkojmë përpara. Ajo që është e sigurt është që e kemi lexuar me shumë vëmendje dhe po e lexojmë me shumë respekt mesazhin e protestës", - shtoi Rama. Në fund ai theksoi se do të flasë prapë të premtën në mbledhjen e asamblesë, duke lënë të kuptohet se aty mund të bëjë publike edhe ndryshimet e përforura qeveritare.



Kryeministri: Vetëkorrigjimi është në ADN-në e Partisë Socialiste

Ksë kryesisë ka deklaruar se për shkak të mungesës së një opozite efektive, PS është e detyruar që për të gjitha gabimet që bën në qeverisje të vetëkorrigjohet. "Kemi pasur një diskutim të gjatë dhe të dobishëm në kuadrin e një procesi të premtuar reflektimi, që sigurisht merr shtytë nga protesta e studentëve, por është në ADN-në tonë dhe është një tjetër shprehje e vetëdijes se çdo ditë ka gjëra për të përmirësuar. Është një sfidë më vete që të vetëkorrigjohemi në vijim", tha Rama. Duke treguar çështjet për të cilat u diskutua në kryesi, ai tha se një nga pikat kryesore ishte protesta e studentëve dhe mësimet që duhen nxjerrë prej saj. "Kemi shumë për të korrigjuar dhe shumë për të përmirësuar dhe është një proces pozitiv. Kemi diskutuar edhe për protestën, arsyet, faktorët, dobishmërinë e madhe të protestës dhe për domosdoshmërinë që ne ta mishërojmë ashtu siç duhet atë që është shqetësimi real i asaj proteste dhe që është transmetuar në formën që ajo mori nga shumë studentë, të cilët i thonë vetes apolitikë, por që në këtë rast e kanë shkundur politikën në raport me vetveten", - u shpreh Rama.

KRIZA POLITIKE AKUZAT

Uljaj, pas skandalit në Unazën e Re? Ish-kryeministri: Nuk sulmoj biznesmenët

Berisha: Rama largohet vetëm me mosbindje civile

"Kthimi në krye të PD? Unë s'jam Napoleoni demokrat"

Ish-kryeministri Sali Berisha, i ftuar mbremë në emisionin "A-Show" në "News 24", foli për situatën aktuale në vend, ndërsa shprehu bindjen se kryeministri Edi Rama largohet vetëm me mosbindje civile.

Z.Berisha përse nuk keni folur asnjëherë për z.Uljaj kohët e fundit, për kompaninë dhe për marrëdhënien e falsifikimit dhe situatën shumë problematike të kompanisë së tij?

E para, nuk besoj të mos kem folur. E dyta, është një ngjarje tepër e shëmtuar dhe di që ka një hetim në Shqipëri dhe në SHBA. Uroj dhe besoj që përgjegjësit e atij mashtrimi të vihen para ligjit. Ndonëse kam bindjen se përgjegjësi kryesor është Edi Rama me Damian Gjikhurin. Zoti Krasta, Shqipëria është sot i vetmi vend në botë që ndërton autostrada me 20 milionë euro kilometrin. Para pak javësh unë kisha një deputet gjerman, nga më të shquarit në Bundestag, dhe më tha 2 milionë a 2 milionë e gjysmë euro kilometri është fare e njohur, dhe këtu është bërë një piramidë e tmerrshme me ndërtime të tyre. Në këtë kontekst, cillido që të jetë përgjegjës, uroj të marrë përgjegjen e merituar. A unë kam një gjë tjetër këtu, një dallim nga të tjerët. Unë ndaj këtyre të pasurve, të cilët sot ndodhen përballë një rryme kundër tyre, unë nuk qëndroj në atë rrymë. Unë nuk qëndroj në atë rrymë, sepse kam një besim më të thellë se ata janë gjeneratorët e punësimit dhe zhvillimit të vendit. Njëllor sikur ata që kanë dhunti poezinë apo të tjerë që kanë dhunti prozën e të tjerë kanë dhunti inxhinierinë, ata kanë dhunti biznesin, kanë dhunti iniciativën e lirë. Ajo dhunti e tyre vërtet i prosperon ata, por edhe shoqërinë. Por, unë jam për rregulla të barabarta, për konkurrencë të ndershme, për zbatim të ligjit. Në këtë kontekst nëse ata qëndrojnë në këtë kuadër, mendoj se përjashtohen të gjitha të tjerët dhe është rruga me e sigurt dhe Edi Rama nuk po e bën. Merr gjashtë vitet e fundit, asnjë kompani ndërkombëtare nuk ka zbraktuar në Shqipëri, asnjë kompani serioze ndërkombëtare nuk ka ardhur në Tiranë për të investuar sepse nuk ka rregulla.

Pse nuk kthehet z.Berisha ta drejtojë tani PD, ka frikë se nuk e mund dot Edi Ramën?
Unë e kam deklaruar shumë herë. Largimi im është pa kthim. Napoleon Bonaparti ishte gjeni, por diktator, unë nuk jam Napoleoni demokrat. Besoj në parimet që shpall.

Si e ndiqni ju personalisht, si një njeri që njihni politikën e dukshme dhe gjithçka ndodh "underground"? Ju tremb juve Veliaj?
Unë them që nëse ka fals dhe pastaj të gjitha mbraja në skenën politike është Veliaj, ai tremb çdo qytetar për



Ish-kryeministri Sali Berisha, dje në emisionin "A-Show"

ZGJEDHJET
"Pse u bënë protestat e çadra? Për zgjedhje të lira, por Rama përfitoi. Rama që nga ajo periudhë ka shtrënguar lidhjet me krimin më shumë se kurrë. Sot bandat janë vendimmarrëset kryesore. E konsideroj të domosdoshme një mosbindje civile për largimin e tij nga pushteti", tha z.Berisha.

Kryemadhi: PS si Buxheti i Shtetit, e drejton një sekt kriminal

Nga Mallakastra, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi akuzoi se premtimet e Ramës janë një tufë me gënjeshtër, që e kanë gënjyer edhe PS. Kryemadhi u shpreh se PS drejtohet nga një sekt kriminal dhe jo nga socializmi që edhe mund të bëjnë gabime. "Mesazhi im është shumë i qartë, sepse është shumë e thjeshtë për t'i konsideruar të gjitha premtimet e Edi Ramës një tufë gënjeshtër, të cilat ju vetëm që kanë gënjyer qytetarët, por mbi të gjitha kanë gënjyer Partinë Socialiste. Unë kam shumë miq në Partinë Socialiste, sepse vij edhe vetë nga PS-ja dhe kur kam ikur nga



aty, ndryshe nga Kejdi apo nga Endriti që kanë qenë femijë në atë kohë dhe sot kanë marrë një pozicionin tjetër, apo Adi që kemi qenë bashkë në Partinë Socialiste, ajo ç'ka kemi vënë re në është që shpërdorimi që i është bërë PS-së ka kaluar çdo kufi, sepse tashmë atë nuk do e drejtojnë social-

Deklarata
"Rama qan dhe zgërdhiet me fatin e 140 mijë studentëve, të cilët kërkojnë minimumin. Pra, kërkojnë kafshatën e fundit të bukës së familjeve të tyre", deklaroi Kryemadhi.
istët me gabimet e tyre dhe defektet e tyre, por e drejton një sekt kriminal, i cili të gjithë pasurinë e Shqipërisë e ka dhënë në trikatër duar, që nuk i dimë kush janë dhe çfarë përfaqësojnë. I cili të gjithë Buxheti e Shtetit e ka dhënë përsëri në 3-4 duar", tha Kryemadhi.

paturpësinë që bën. Një kryetar bashkie që paraqet veten në Tiranë në një kohë që atë muaj ka qenë 18 herë jashtë shtetit, t'i thuasht i pafytyrë e fyten këtë fjalë. Ai përbën falsitetin më të madh në historinë e këtij vendi.
A ka mundur PD e sotme ta formulojë së brendshmi një mesazh, do fitoni zgjedhje që të jeni rivalë të fortë apo në të presim që PD të shkojë deri në fund me atë shpërbërje që ka treguar?
Unë jam i sigurt se nëse Shqipëria do të zgjedhje, PD do i fitojë. Problemi është se Shqipëria nuk ka zgjedhje, se ato i përcak-

tojnë bandat, prandaj misioni i PD është përmbyesja e Ramës jo për të ardhur në pushtet me forcë, por për të krijuar kushtet për zgjedhje të lira. Pse u bënë protestat e çadra? Për zgjedhje të lira, por Rama përfitoi. Rama që nga ajo periudhë ka shtrënguar lidhjet me krimin më shumë se kurrë. Sot bandat janë vendimmarrëset kryesore. E konsideroj të domosdoshme një mosbindje civile për largimin e tij nga pushteti.
Çfarë marrëdhënie keni ju me të? Kam përshtypjen se ju jeni "inside his head". Jeni folësi çip në kokën e tij.

Unë jam mjek dhe shoh dhe përroin psikik të tij, i cili është një grup që prodhon një llum negativitetesh, vërshojnë në vend në mënyrën më të padurueshme. Ky njeri potencialin negativ të problemit të tij psikik e çon drejt qytetarëve. Merr rastet e fundit, fishekzjarrët, a mundet njeri në botë? Se ka frikë vetë se mos e gjuajnë studentët me fishekzjarrë dhe ndalon kombinin? Si mund t'ua ndalosh femijëve? Unë ia njoh psikologjinë shqiptare. Ai po përdor atë vajzën, policen. Fishekzjarrët në të gjithë botën dihet që kanë fuqi eksplozive, duhen përdorur me kujdes, po nuk

"Të anulohet vendimi, të rishqyrtohet dekreti"

Dekreti i presidentit për dividendin, PD-LSI letër Kuvendit: U shkel rregullorja

Opozita parlamentare PD dhe LSI kërkojnë rishqyrtimin e dekretit të Presidentit Ilir Meta për dividendin "Tatimin mbi të ardhurat". Krerët e grupeve parlamentare, Edmond Spaho dhe Petrit Vasili i dërguan dje një letër Këshillit për Rregullorën dhe kryeparlamentarit Gramoz Ruçi. Në letërën e PD-LSI thuhet se mazhoranca ka shkelur rregullorën në secancën e 20 dhjetorit, pasi brenda 12 orësh dekreti erdhi në Kuvend dhe më pas u mblodh në shkelje të rregullores Këshilli i Ekonomisë, që rrezoi dekretin. Opozita kërkon që të evidentohet shkelja e rregullores, të anulohet vendimi i Komisionit të Ekonomisë dhe të rishqyrtohet dekreti i Presidentit Ilir Meta për dividendin. Në argumentin e saj opozita shprehet se nëse pakicës i mohohet e drejta e saj kushtetuese për t'u njohur me çështjet që shqyrtohen e miratohen në Kuvend, sipas rregullave dhe afatëve të përcaktuara nga Rregullorja e Kuvendit, atëherë ky veprim antikushtetues tenton të asgjësojë de facto rolin e opozitës në parlament, që është jetik për funksionimin demokratik të shtetit shqiptar. Në këto kushte, opozita i kërkon Këshillit të Mandateve të konstatojë shkeljen e rregullores së Kuvendit si dhe i kërkon kryeparlamentarit Ruçi shqyrtimin dhe miratimin e dekretit të Presidentit për kthimin në Kuvend të ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Pas interpretimit të Presidentit Ilir Meta se dekreti i tij për ligjin e tatimit mbi të ardhurat është rrezuar duke shkelur procedurën e Kuvendit, biznesi kërkojnë që Kuvendi të bëjë 0 taksën e dividendit nëse e merr dhe njëherë ligjin në shqyrtim. Presidenti Ilir Meta ktheu në Kuvend dekretin për "Tatimin mbi të ardhurat" në 20 dhjetor, me pretendimin se ka shkelur barazinë fiskale me aksionerët.

Statulli që i bëni ju kryeministrit është final dhe i vazhdueshëm.
Më fal a i tha studentit: A ke marrë 'Ipohn-in', ku e ke marrë atë? Studentit i tha: Po ti Surrelin? Studentit i tha: Kam qenë emigrant. Por në emigracion ai ka një akuzë që s'u vërtetua kurrë. Fatos



Grupe të numërimit të votave gjatë zgjedhjeve të shkuara

Nano i tha: Ke shitur ikona të vjedhura. Dhe unë s'kam hyrë në hetimin e saj, por di që ikona janë vjedhur me qindra e mijëra dhe që bllokmenët morën ikonat kur u prishën kishtat. Këtë e di mirë. Po ku i deklaroi ato pasuri? Çfarë taksa pagoi? A ka paguar taksa? Tek cila bandë i kaloi ato?! Për t'i mbyllur të gjitha këto, se ishin para të vjedhura, shkarkoi Zana Xhukën. Sapo kryetarja e LLKDP-së hapi hetimin, akti i parë që bëri Rama, e shkarkoi. I mijë metër katrorë sipërfaqe banimi në Surrel dhe i thoshte studentit; po këtë "Ipohn"?! Pra, ky është përroi i tij psikik.



VLERA E SHPËRBLIMIT PËR ÇDO KOMISIONER

1. Kryetarin dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së do paguhet me 65 mijë lekë
2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-ve do të paguhet me vlerën 60 mijë lekë
3. Kryetari i KQV-së do të paguhet me vlerën 4 mijë lekë
4. Anëtarë dhe sekretari i KQV-së do të paguhet me vlerën 3500 lekë
5. Anëtarë i Grupit të Numërimit të Votave do të paguhet me 6 mijë lekë

Zgjedhjet vendore, KQZ hap 337 vende pune për 6 muaj

Zgjedhjet e ardhshme vendore që do mbahen në qershor do jenë një mundësi e mirë edhe punësimi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përgatitur projektvendimin për miratimin e strukturës, organikës dhe pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune që do të rekrutohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Drejtoria përkatëse e burimeve njerëzore në KQZ ka bërë përllogaritjen e nevojave në staf për secilin drejtori dhe i ka paraqitur këtij komisioni projektvendimin për të miratuar një kontingjent punonjësish prej 337 personash. Punonjësit e kategorive të ndryshme që do të rekrutohen, do të punojnë për periudhë të përgatitjes së zgjedhjeve deri në përfundimin e të gjitha detyrimeve ligjore, që ka në të gjitha strukturat e administratës së KQZ-së. Punonjësit mbështetës që do të merren me kohë jo të plotë pune, do të kenë të përcaktuar, gjithashtu, edhe strukturën e pagave të tyre, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave për pagat e nëpunësve dhe punonjësve mbështetës të disa institucioneve buxhetore. Pagat do të jenë në varësi të funksionit dhe punës që do bëjë gjithsecili dhe fillojnë nga punonjës mbështetëse deri te specialistë me paga që shkojnë deri në 40 mijë lekë në muaj. Ndërkohë që afatet kohore të punësimit variojnë nga 1 muaj minimalja deri në 6 muaj maksimalja. Në përcaktimin e numrit dhe emërtesës së pozicionit të punës është analizuar ngarkesa e punës referuar detyrave të shuara të Institucionit të KQZ-së, lidhur me detyrimet e zbatimit të ligjit Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", (regjistrimi, administrimi, përpunimi, skanimi dhe verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit si një proces pune voluminoz e në një kohë relativisht të shkurtër).

KQZ do miratojë nesër vendimin, shpërblimi i komisionerëve deri në 600 mijë lekë

Vendimi, ja sa do të paguhet 42 mijë komisionerët e zgjedhjeve vendore

Anëtarët e qendrave të votimit do të marrin 40 mijë lekë

Ndërsa partitë politike nuk kanë arritur ende të gjejnë konsensusin dhe miratojnë ndryshimet zgjedhore që do të depolitizojnë komisionet e administrimit të zgjedhjeve, KQZ në përbashkëri me shtetin dhe bashkitë, ka vendosur që t'i organizojë zgjedhjet me Kodin e vjetër Zgjedhor. Për rrjedhojë edhe komisionet zgjedhore në nivel KZAZ-je dhe KQV-je do jenë me përbërje politike dhe me nga 7 anëtarë. Për secilin për tyre, ashtu si edhe në zgjedhjet e shkuara vendore do të ketë një masë shpërblimi, kjo në varësi të nivelit të komisionit ku bën pjesë dhe të pozicionit që mban në të, duke filluar nga 3500 lekë të vjetër deri në 650000 lekë të vjetër. Në total bëhet fjalë për afro 42 mijë komisionerë që do të shërbejnë në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, në Komisionin e Qendrës së Votimit dhe në Grupin e Numërimit të Votave.

42 MIJË

Në total bëhet fjalë për afro 42 mijë komisionerë që do të shërbejnë në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, në Komisionin e Qendrës së Votimit dhe në Grupin e Numërimit të Votave.

Për miratimin e strukturës, organikës dhe strukturën e pagave, të punonjësve me kohë jo të plotë pune, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019				
Lidhja 1				
Nr.	Emërtimi	Klasa	Numri	Koha e punësimit
1	Sekretar për Anëtarët e KQZ-së	61950	7	6 muaj, ditë në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve
II Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimin dhe Edukimit të Zgjedhësve				
1	Specialist	IV - b	5	5 muaj
2	Specialist, teknologji informacioni	IV - b	1	5 muaj
3	Specialist, inspektor për Zyrat Rajonale Zgjedhore	IV - b	28	5 muaj
4	Specialist për trajnimet	IV - b	3	5 muaj
5	Specialist, grafist	IV - b	1	4 muaj
6	Specialist për edukimin e zgjedhësve	IV - b	1	5 muaj
7	Specialist, redaktor	IV - b	1	4 muaj
8	Specialist logjistike-trajnim	IV - b	1	2 muaj
III Drejtorja e Shërbimeve dhe Logjistikës				
1	Specialist Logjistike	IV - b	2	5 muaj
		IV - b	15	4 muaj
2	Specialist Shërbimesh	IV - b	3	3 muaj
3	Specialist Teknik Salje	IV - b	2	4 muaj
4	Forist	VI	2	5 muaj
5	Elektricitet	VI	2	3 muaj
6	Punëtor logjistike	III	75	4 muaj
7	Punëtor	III	15	2 muaj
8	Punëtor magazinore	III	5	5 muaj
9	Fotokopues	IV	3	4 muaj
10	Ndërmes magazinier	VI	1	5 muaj
11	Punëtor pastimi	I	2	5 muaj
IV Drejtorja e Teknologjive dhe Informacionit				
1	Specialist IT	IV - b	6	6 muaj
2	Specialist, për kontrollin e të dhënave elektronike	IV - b	3	2 muaj
3	Specialist, për faqet e buletin	IV - b	3	2 muaj
4	Specialist, për hartat	IV - b	1	4 muaj
5	Operator për qendrën e informimit	V	6	3 muaj
6	Operator për hedhjen e të dhënave për procesin zgjedhor	V	25	2 muaj
7	Operator për kontrollin elektronik të tabelave të rezultateve	V	5	1 muaj
8	Operator për skanimin e formularëve të vetëdeklarimit	V	30	2 muaj
9	Operator për kontrollin manual të tabelave të rezultateve	V	40	1 muaj
V Drejtorja e Burimeve Njerëzore				
1	Specialist, për marrëdhëniet e punës	IV - b	2	6 muaj
2	Specialist, jurist për prokurimet	IV - b	2	4 muaj
3	Specialist, Aktivitetin e Shtetit	IV - b	215	6 muaj
4	Specialist, Protokolli	IV - b	4	6 muaj
5	Specialist, Sekretaria Teknike	IV - b	416	4 deri 6 muaj
7	Operator Protokolli-Aktivi	V	7	5 deri 6 muaj
9	Fotokopues	IV	1	4 muaj
10	Postier	II	3	4 muaj
VI Drejtorja Juridike				
1	Specialist, Jurist	IV - b	5	6 muaj
2	Specialist, Jurist	IV - b	5	4 muaj
3	Operator për të dhënat e formularëve të deklarimit	V	5	4 muaj
VII Drejtorja e Marrëdhënieve me Lidhjet				
1	Specialist	IV - b	1	5 muaj
2	Specialist, përkthyes	IV - b	2	5 muaj
VIII Drejtorja e Financës				
1	Specialist	IV - b	3	6 muaj
IX Zyra e Shtypit				
1	Specialist për monitorimin e mediave	IV - b	2	3 muaj
	Specialist përkthyes	IV - b	1	6 muaj
Gjithsej			337	

anëtarëve të KZAZ-ve. Kështu kryetari i KQV-së do të paguhet me 40 mijë lekë, ndërsa anëtarët me nga 35 mijë lekë.

GNV

Gjithashtu, projektvendimi i KQZ-së përcaktonte edhe masën e shpërblimit për gjithë anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Numri i anëtarëve të GNV-ve nuk është fiks dhe ai do përcaktohet nga KZAZ-të, në varësi të numrit të kutive të votimit dhe situatës

apo problematikës që do mbart procesi i numërimit të votave. Për shkak se puna e anëtarëve të GNV-së mund të zgjasë më shumë se një ditë, KQZ ka parashikuar që ata të shpërblehen me nga 60 mijë lekë të vjetër.

TIRANË - Një avokat ka përfunduar në prangat e policisë nën akuzën e korrupsionit aktiv ndaj gjyqtarëve. Bëhet fjalë për avokatin Sokol Gjini, i cili ka tentuar korrupsionin e një gjyqtari të Gjykatës së Kurbinut, me qëllim lirinë e klientit të tij nga burgu. Mësohet se Gjini ka kërkuar ndryshimin e masës së sigurisë për Eriger Bushi (Gentian Bushi) Bushin. 38-vjeçari (person me precedentë të mëparshëm penalë) u arrestua më 22 qershor të këtij viti, pasi ishte në kërkim. Pas ar-



Tentoi të korrumpojë gjyqtarin për lirinë e klientit të tij, arrestohet avokati Sokol Gjini

restimit, policia bëri me dije se Gjykata e Shkallës së Parë Kurbin me vendimin nr.1188 datë 31.05.2018, kishte caktuar ndaj tij masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Mbatje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionëve", "Kanosja" dhe "Plagosje e lehtë me dashje". Ndërkaq, Prokuroria e Krimeve të Rën-

da sqaroi se: "Janë arrestuar shtetasit Sokol Gjini me detyrë avokat dhe Eriger Bushi lindur e banues në Laç, për veprën penale 'Korrupsion aktiv i gjyqtarit' neni 319 K. Penal. Për shtetasin Llesh Bushi është caktuar masa detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Të arrestuarit kanë kryer veprime me qëllim korrupsionin e gjyqta-

rëve për të mundësuar ndryshimin e masës së sigurimit për shtetasin Eriger Bushi". Nga ana tjetër, mësohet se gjyqtari që ka pasur çështjen nuk ka pranuar rryshfëtin. Për të provuar këtë rast korrupsioni, prokuroria ka siguruar veç përgjimeve, edhe pamje filmike që vërtetojnë akuzën e korrupsionit aktiv për avokatin Sokol Gjini.

Roja i kazinosë në gjykatë: S'ndërhyra për t'mos rrezikuar vendin e punës

Shoqja e Marvi Mihalit: Armend Haxhiu më tha se e goditi Eugen Bitraj

"Ditën e ngjarjes isha me të dhe disa miq në sheshin 'Nënë Tereza', e telefonuan"

TIRANË

Gjykata e Tiranës vazhdon të marrë dëshminë e personave për vrasjen e Marvi Mihalit, i cili u vra për një karikues telefoni në korrik të vitit të kaluar. Në seancën gjyqësore që u zhvillua ditën e djeshme ka dhënë dëshminë shoqja e viktimës, Gresi Stërmasi, e cila ishte me të ditën e ngjarjes. Sipas TV "Klan", Stërmasi ka pohuar para togave të zeza se atë ditë ishte me Marvin dhe disa miq në sheshin "Nënë Tereza". Sipas saj, miku i tij, Armendi e kishte marrë në telefon duke i kërkuar të shkonte tek stadiumi "Dinamo", pasi kishte konflikt me disa persona. Armendi i kishte thënë më pas në spital shogës së tij se 21-vjeçarin e kishte qëlluar me thikë Devi Bitraj. Dëshmi ka dhënë edhe Besim Sokolaj, i cili ka qenë prezent kur ka ndodhur krimi, pasi punonte roje në një kazino. Sokolaj është shprehur se nuk e kishte parë momentin e vrasjes së Marvit, por vetëm një përleshje mes disa të rinjve. Sokolaj sqaroi se nuk kishte ndërhyrë, pasi nuk donte të rrezikonte vendin e punës. Kjo dëshmi solli dhe reagimin e prindërve të Marvi Mihalit, të cilët thanë se ndërhyrja e rojës mund t'i kishte shpëtuar jetën djalit të tyre. Në seancën e ardhshme të datës 14 janar do të japin dëshmitë e tyre dy personat e arrestuar, Devi dhe Eugen Bitraj. Ndërsa në kërkim vazhdojnë të jenë Marsel dhe Gridhens Alla.

VRASJA

Studenti 22-vjeçar, Marvi Mihalit u vra më 31 korrik të vitit 2017 në zonën e stadiumit "Dinamo". Sipas buri-



Viktima Marvi Mihalit

meve policore, por edhe nga dëshmitë e dhëna në sallën e gjyqit, miku i tij, Armend Haxhiu i kishte shitur një telefon Devi Bitraj, por nuk i kishte dhënë karikuesin. Pas debateve mes Armendit dhe Bitrajve është vendosur që të takohen për t'u sqaruar të stadiumi "Dinamo". Armend

Haxhiu ka kërkuar që aty të shkonte edhe miku i tij, Marvi Mihalit dhe pas shumë telefonatash, ka arritur ta bindë Marvin. Mësohet se mes të rinjve të konfliktuar ka pasur një debat mes 19-vjeçarit Dejvi Bitraj, Marvi Mihalit dhe mikut të këtij të fundit. Më pas shëri ka agravuar, pasi Dejvi Bi-

traj ka thirrur në ndihmë kushërinin e tij, Eugen Bitraj, i cili ka shkuar bashkë me 3 shokë të tjerë. Pasi kanë rrahur Marvin në rrugicën para lokalit, Dejvi Bitraj e ka goditur me thikë në zemër duke i çarë aortën. Marvi Mihalit ndërroi jetë disa minuta më pas në spital.

Avokati: Taulant Muka, "doraci" i Soros për të shantazhuar pedagogët

Avokati Altin Goxhaj ka hedhur akuza të forta në drejtim të ish-zv.ministrit të Arsimit, Taulant Muka. Në një postim në rrjetet sociale, Goxhaj e cilëson Mukën si "dorac" të Soros, për të shantazhuar pedagogët që kërkojnë shfuqizimin e Ligjit për Arsimin e Lartë. "Tao Muka është DORACI që përdor Pushtetin Soros për të sulmuar pedagogët që kërkojnë shfuqizimin e Ligjit Sorosian për Arsimin e Lartë! Ne të gjithë jemi të angazhuar për të inkurajuar peda-



Avokati Altin Goxhaj

gogët për të kërkuar shfuqizimin e Ligjit Kriminal të Arsimit të Lartë, dhe futet ky Tao që na solli Fondacio-

ni Soros Kosovë (KFOS) për të shantazhuar me pralla pedagogët!", shkruan Goxhaj në postimin e tij.



Gjykata e Lartë, institucioni "fantazmë" ku flenë 30 mijë dosje

TIRANË - Institucioni kryesor i piramidës së drejtësisë, Gjykata e Lartë është inekzistente. Vetingu e la me 4 gjyqtarë Gjykatën e Lartë. Pamundësia e formimit të kolegeve 5-anëtarëshe Penale dhe Civile kanë bërë që shifra e çështjeve që presin radhën për gjykim të shkojë në mbi 30 mijë. Por, problemi i dosjeve të mbartura e për rrjedhojë i vonës në gjykim është krijuar ndër vite për shkak të mosplotësimit të trupës së kësaj gjykate me anëtarë. Viti 2018 e gjeti gjykatën me 9 anëtarë, por procesi i vetingut shkarkoi nga detyra 5 prej tyre, duke e pamundësuar formimin e kolegeve me pesë anëtarë për çështjet penale dhe civile. Referuar të dhënave nga Gjykata e Lartë, numri i dosjeve gjyqësore penale, civile dhe administrative që presin gjykimin ka kaluar shifrën 30 mijë, raporton "Abc News". Aktualisht gjykata shqyrtor në themel vetëm çështjet administrative, rekurset e tyre shqyrtohen nga kolege 3 anëtarësh. Sipas të dhënave, në periudhën qershor-dhjetor 2018 janë gjykuar në total 308 çështje administrative, nga të cilat 273 prej tyre në Dhomë Këshillimi dhe 35 prej tyre në seancë gjyqësore. Ndërsa çështjet penale dhe civile nuk mund zbrisin në sallat e gjyqeve. Gjyqtarët e mbetur shqyrtojnë në Dhomat e Këshillimit vetëm çështje urgjente, si masat e sigurimit, apo ekstradime. Të dhënat nga Gjykata e Lartë tregojnë se në dhomë këshillimi në harkun qershor-dhjetor të këtij viti janë shqyrtuar 152 çështje civile dhe 161 çështje penale. Ndërsa, gjykata është në ngërc, në kryesekretarinë e saj depozitohen çdo ditë mesatarisht 50 rekurse, duke shtuar numrin e dosjeve dhe zënien e çdo hapësire në godinën e Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë duket se shpresë sjell vetëm lajmi i nisjes së funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Digjet tregu industrial në Laç, tregtarët: Gjetëm bidonë benzine

LAÇ - Mëngjesin e djeshëm, një zjarr i madh ka përfshirë tregun industrial të Laçit. Si pasojë e flakëve janë shkaktuar dëme të shumta materiale, por fatmirësisht nuk ka persona të lënduar. Tregu industrial është rreth 800 metra dhe në të shiten veshmbathje të ndryshme. Mësohet se në momentin që ka rënë zjarri nuk ka pasur energji elektrike. Policia dyshon se zjarri ka qenë i qëllimshëm, ndërsa tregtarët u shprehën se ka pasur prej kohësh konflikt mes pronarit të tregut industrial si dhe pronarëve të tokës ku është ndërtuar tregu. Gjithashtu, tregtarët kanë gjetur edhe një bidon benzine, i cili është sekuestruar nga blutë si provë materiale. Ndërkaq, policia po heton për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.



DOSJA/ Ja si u zbulua aktiviteti kriminal në Francë i pjesëtarëve të familjes Perlesi

Klodiana Haxhijaj

DURRËS

Prokuroria e Durrësit ka dhënë pretendencën për ish-bashkëshortët Aleko Perlesi dhe Drane Kola nga Shijaku, të cilët akuzohen se kanë vënë pasuri të konsiderueshme përmes shfrytëzimit të prostitucionit. Në dosjen e plotë të organit të akuzës së qytetit bregdetar, të siguruar nga "Gazeta Shqiptare" mësohet se ndaj ish-çiftit rëndon akuzat "Pastrim të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale", kryer në bashkëpunim. Ndërkaq, prokuroria bën me dije se Aleko Perlesi është i procedurës penale me 11 tetor të 2013-ës. Në dosje thuhet se me paratë e fituara nëpërmjet shfrytëzimit të prostitucionit ai ka blerë apo po ndërton prona të paluajtshe në zonën e Durrësit dhe i ka vendosur në emër të pandehurës Drane Kola, ish-bashkëshortja e tij. Në pretendencën e saj, prokuroria kërkon shpalljen fajtor të dy shtetasve në fjalë si dhe dënimin e tyre në total me 15 vite burg.

DOSJA E PLOTË E PROKURORISË

Prokuroria e Durrësit, në mbështetje të nenit 378/1 të Kodit të Procedurës Penale i paraqiti Gjykatës konkluzionet përfundimtare për çështjen penale nr.48 të vitit 2014. Çështja penale për akuzat "Pastrim të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga neni 287/2 germa "b" dhe "c" të Kodit Penal është në ngarkim të pandehurës Aleko Perlesi dhe Drane Kola.

Procedimi penal filloi pas kallëzimit të shtetasës Q.P. (M) më 11 tetor 2013 ndaj të pandehurit Aleko Perlesi, sipas të cilit ky i fundit me paratë e fituara nëpërmjet shfrytëzimit të prostitucionit ka blerë apo po ndërton prona të paluajtshe në zonën e Durrësit dhe i ka vendosur në emër të pandehurës Drane Kola, ish-bashkëshortja e tij.

I pandehuri Aleko Perlesi, me vendimin nr.146, dt.15.03.2007 të Gjykatës Durrës u dënua me 4 vjet e 8 muaj burg për "Shfrytëzim të prostitucionit në rrethana rënduese" sipas nenit 114/a/2,5 të K.Penal, në dëm të shtetasës V.P., E.M., K.D. etj.

Ky procedim penal ndaj të pandehurit Aleko Perlesi ka filluar mbi bazën e letërporsisë së autoriteteve gjyqësore franceze, të cilët nga ana e tyre kishin filluar hetimet për veprimtarinë e shfrytëzimit të prostitucionit në zonën e Nancy në Francë të disa femrave shqiptare dhe rumune nga Aleko Perlesi me djemtë e tij, Dritan dhe Xhevahir Perlesi. Sipas vendimit të gjykatës, një vajzë e re ka

Para dhe pasuri nga prostitucioni, prokuroria: 15 vite burg në total për ish-çiftin nga Shijaku

"Aleko Perlesi bleu prona në zonën e Durrësit, i kaloi në emër të ish-bashkëshortes, Drane Kola"

PROCEDIMI PENAL

Aleko Perlesi, me vendimin nr.146, dt.15.03.2007 të Gjykatës së Durrësit u dënua me 4 vite e 8 muaj burg për "Shfrytëzim të prostitucionit në rrethana rënduese" në dëm të shtetasës V.P., E.M., K.D., etj. Ky procedim penal ndaj të pandehurit Aleko Perlesi ka filluar mbi bazën e letërporsisë së autoriteteve gjyqësore franceze, që nga ana e tyre kishin filluar hetimet për veprimtarinë e shfrytëzimit të prostitucionit në zonën e Nancy në Francë të disa femrave shqiptare dhe rumune nga Aleko Perlesi me djemtë e tij Dritan dhe Xhevahir Perlesi.



Prokuroria e Durrësit

RRJETI I PROSTITUCIONIT

Sipas vendimit të gjykatës, një vajzë e re ka denoncuar ekzistencën e një rrjeti të gjerë prostitucioni shqiptar e rumun, të vendosur në zonën e Nancy në Francë, por të shtrirë edhe në qytete të tjera si Avignon, Lyon dhe Toulouse. Ky grup drejtohej nga familja Perlesi dhe Mehmet Ademov. Po sipas vendimit të gjykatës, V.P., E.M., K.D. kanë qenë prostituta në Francë që nga viti 2002 për llogari të "klanit" Perlesi, por duke u implikuar edhe në organizimin dhe kontrollin e prostitutave të tjera për llogari të klanit familjar.

SHKURT

Abuzimet me pronat, Apeli i të lirë 2 nga 5 të arrestuarit

KORÇË - Gjykata e Apelit të Korçës ka lënë të lirë dy nga pesë të arrestuarit për abuzime me pronat në hipotekën e qytetit juglindor. Mësohet se janë lënë të lirë kundrejt një garancie pasurore, Leftjon Bardho dhe Andrea Zallami, ndërkohë Apeli la në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg" për tre të tjerët si: Ersild Gorari dhe Erjon Arif dhe Arsidisa Hysi. Abuzuesit e pronave kanë qenë në kontroll të rreptë nga strukturat ligjzbatuese dhe për këtë janë shoqëruar dhe proceduar shumë funksionarë nga veriu deri në jug të vendit.

Me dokumente false drejt Anglisë, dënohet me burg shqiptari

MALTË - Një shqiptar është dënua me 18 muaj burg në Maltë, pasi u kap duke udhëtuar me dokumente të falsifikuara me destinacion Mançesterin e Anglisë. I dënua, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije ka përdorur para gjykatës se ka blerë 3 dokumente të falsifikuara italiane me një shumë prej 1200 eurosh. Ai është shprehur se arsyja që e ka futur në këtë lojë ka qenë fakti se i ishte refuzuar më parë udhëtimi drejt Anglisë, përcjell "independent.com.mt". Pas shqyrtimit të rastit të shqiptarit, gjykata vendosi dënimin e tij me 1.6 vite burg si dhe 3 vjet pezullim në zonën shpen.

Shantazhonte për pazare droge, kapet 36-vjeçari shqiptar

ITALI - Një shqiptar është prangosur në Besozzo (qytet në krahinën e Vareses) në Itali. I arrestuari është i moshës 36 vjeç, por identiteti i tij nuk bëhet me dije. Sipas mediave lokale në Itali, shqiptari ishte shkuar si autor i një sërë kërcënimesh, të cilat dyshohen se janë të lidhura me trafikun e drogës. Gjatë shërbimit të policisë, shqiptari u kap pasi kërcënoi verbalisht një vajzë me synim përfundim të një sasive parash prej 1200 eurosh. Hetimet zbuluan se shqiptari kishte kërcënuar edhe në rast të tjera po të njëjtën vajzë.

KËRKESA PËR KOFIKIMIN E PASURISË SË SHTETASËS DRANE KOLA

- a) Pasurisë nr.12/40, tokë arë 420 m2 në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- b) Konfiskimin e pasurisë nr.27/44, tokë arë 2930 m2, në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- c) Konfiskimin e Pasurisë nr.27/20, tokë arë 2750 m2, në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- d) Heqjen e sekuestros për llogaritë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetasës Drane Kola, Athina Perlesi dhe Valbona Perlesi.

• Deklarimin fajtor të pandehurës Drane Kola për veprën penale: "Pastrim të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale" e kryer në bashkëpunim në kuadrin e fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë të pronësive ose të drejtave në lidhje me pasurinë duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale si dhe fitim i marrjes në dorëzim që kjo pasuri është produkt i veprës penale, veprë kjo e parashikuar nga neni 287/2 germa "b" dhe "c" të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 7 vjet burgim.

• Deklarimin fajtor të pandehurit Aleko Perlesi, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprim-

tarisë kriminale" e kryer në bashkëpunim në kuadrin e fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë të pronësive ose të drejtave në lidhje me pasurinë duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale, veprë kjo e parashikuar nga neni 287/2 germa "b" dhe "c" të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim.

• Duke u referuar dhe vendimit gjyqësor nr.8 datë 14.6.2016 dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë si dhe të vendimit gjyqësor nr.324 datë 19.4.2014 dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me objekt vendosje të masës së sigurimit pa-

suror u kërkua nga gjykata konfiskimi i:

- a) Pasurisë nr.12/40, tokë arë 420 m2 në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- b) Konfiskimin e Pasurisë nr.27/44, tokë arë 2930 m2, në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- c) Konfiskimin e Pasurisë nr.27/20, tokë arë 2750 m2, në Rreth, Shijak në emër të shtetasës Drane Kola.
- d) Heqjen e sekuestros për llogaritë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetasës Drane Kola, Athina Perlesi dhe Valbona Perlesi.

• Shpenzimet procedurale në fazën e hetimit me shumën 5.000 lekë t'i ngarkohen solidarisht të pandehurës: Drane Kola dhe Aleko Perlesi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall:

- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit.

KËRKESA TË POSAÇME:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- b) Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- e) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESA TË POSAÇME:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet

përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Guvernatori: Bilanci, kreditë me probleme janë ulur në 12.7% në nëntor

Sejko: Rritje interesash në gjysmën e dytë të vitit

"Rënia e prodhimit të energjisë ka ngadalësuar ekonominë"

Banka e Shqipërisë ka vendosur që të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 1%, por ka paralajmëruar se mund të ketë një ndryshim të kursit drejt rritjes në gjysmën e dytë të vitit 2019. Banka ka paralajmëruar se ekonomia ka vijuar trajektoren rritëse në gjysmën e dytë të 2018-s, por ulja e prodhimit të energjisë elektrike vlerësohet të ketë ndikuar në ngadalësimin e saj. Monitor raporton se këto informacione u bënë të ditura nga guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare, ku ka paraqitur dhe një përmbledhje të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2018. Aktiviteti ekonomik ka vijuar rritjen në gjysmën e dytë të 2018-s, nga të dhëna të tërthorta si rritja e punësimit dhe ulja e punësimit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik pasqyron rritjen në prodhim dhe shërbime. Megjithatë si rrjedhojë e uljes së prodhimit të energjisë pritet një ngadalësim i ekonomisë në gjysmën e dytë të vitit, tha Sejko. Guvernatori tha se politika monetare ka pasur ndikim pozitiv dhe mbetet e përshtatshme. Kjo politikë monetare është transmetuar përmes uljes së normës bazë dhe injektimit të likuiditetit të vazhdueshëm, si dhe ndërhyrjes në tregun valutor në periudhën e verës. Interesat e ulëta kanë mbështetur zgjerimin e kredive, që u rrit me mbi 4%, i pastruar nga kreditë e këqija dhe nxjerrja e huave jashtë bilancit. Kreditë me probleme janë ulur në 12.7% në nëntor. Ndërhyrja e përkohshme në tregjet valutore ka balancuar kërkesën dhe ofertën valutore, tha Sejko. Krahu konsolidues i politikës fiskale në gjysmën e dytë të vitit ishte më i fortë se ai i parashikuar duke pa-



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

RRITJA EKONOMIKE

"Aktiviteti ekonomik ka vijuar rritjen në gjysmën e dytë të 2018-s, nga të dhëna të tërthorta si rritja e punësimit dhe ulja e punësimit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik pasqyron rritjen në prodhim dhe shërbime. Megjithatë si rrjedhojë e uljes së prodhimit të energjisë pritet një ngadalësim i ekonomisë në gjysmën e dytë të vitit", tha Sejko. Guvernatori tha se politika monetare ka pasur ndikim pozitiv dhe mbetet e përshtatshme.

sur me pak shpenzime nga ana e qeverisë. Megjithatë, në balancë, ecuria ekonomike në gjysmën e dytë të vitit ka qenë pozitive. Rritja ekonomike ka krijuar premisa për të çuar inflacionin në objektiv në afatin e mesëm. Sejko tha se inflacio-

ni prej 1.8% është nën objektivin e Bankës, për shkak të nënçmimit të euros. Sejko tha se pritet që inflacioni të kthehet në objektiv në gjysmën e dytë të vitit të ardhshme. Në këto rrethana, Banka e mbajti të pandryshuar normën bazë në nive-

lin e 1%. Ruajtja e intensitetit të stimulit monetar pritet të rrisë kërkesën agregate, tha Sejko, duke shtuar se rritja e normës bazë nuk do të fillojë para tremujorit të dytë të vitit 2019.

FORCIMI I LEKUT

Banka e Shqipërisë, si pjesë e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme në tregun valutor dhe për efekt të rritjes së rezervës valutore ka blerë rreth 400 milionë euro gjatë gjysmës së dytë të këtij viti. Shifra u bë e ditur nga guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko gjatë konferencës së fundvitit. Sejko tha se oferta në valutë u rrit në mënyrë të dukshme nga konvertimi i kapitalit të bankave dhe disbusimi i kredisë për energjinë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim,

TREGU VALUTOR

Banka e Shqipërisë, si pjesë e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme në tregun valutor dhe për efekt të rritjes së rezervës valutore ka blerë rreth 400 milionë euro gjatë gjysmës së dytë të këtij viti. Shifra u bë e ditur nga guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko gjatë konferencës së fundvitit. Sejko tha se oferta në valutë u rrit në mënyrë të dukshme nga konvertimi i kapitalit të bankave dhe disbusimi i kredisë për energjinë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim,

nga konvertimi i kapitalit të bankave dhe disbusimi i kredisë për energjinë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, transaksione që vlerësohen në rreth 400 milionë euro. "Në një moment u detyruam të ndërhyjmë, pasi nënçimi i euros po prekte objektivin e inflacionit", tha Sejko. Për momentin, Banka vlerëson se nënçimi i euros ka një efekt më të ulët në inflacion, por, nëse do të shihet që ndikimi do të jetë i fortë, atëherë mund të marrë në konsideratë sërish ndërhyrjen. "Agjentët mund të marrin masa për t'u mbrojtur nga kursi i këmbimit,

duke e përcaktuar kursin në kontratë, kjo është e vetmja mënyrë për të shmangur këtë rrezik", shtoi guvernatori. Aktualisht Banka po e monitoron situatën dhe po kryen analiza për të përcaktuar shkaqet e vlerësimit të lekut. Sejko tha se kanë ndikuar faktorët sezonalë, si dhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë intensifikuar mbiçmimin e lekut, si investimet e huaja, eksportet si dhe konvertimi i kapitalit të bankave dhe kredia e BERZH. Aktualisht, tha ai, mbiçmimi nuk shfaq probleme, kjo është sjellje normale që vjen nga shtimi sezonal i valutës. "Ne kontrollojmë lekun, jo euron, por përpiqemi përmes analizave tona të gjykojmë dhe vlerësojmë sa është ndikimi i euros në qarkullim për të pasur parasysh se si do të ndikojnë në politikën tonë monetare", tha Sejko. Euro ra me shpehtësi nga rreth 134 lekë në fillim të vitit në 124.17 lekë në 5 qershor, dhe u stabilizuar në nivelin e 126 lekëve pas ndërhyrjes në verë të Bankës së Shqipërisë, por nga muaji shtator ajo sinjalizoi tregjet për tërheqje, çka bëri që monedha e përbashkët të hynte sërish në një trajektore të pandalshme rënëse. Që nga 16 janari, kur arriti nivelin më të lartë të vitit prej 133.99 lekë, euro ka rënë me 11.2 lekë, ose 9.1%, duke shënuar nënçimin më të madh vjetor që prej vitit 2004.

Taksa e rrugës "bllok" turizmin, në dy muaj 40 mijë kosovarë më pak

Në tetor dhe nëntor, që përkon me periudhën që u vendos taksa e Rrugës së Kombit, hyrjet e shtetasve nga Kosova kanë shënuar rënie të ndjeshme, në krahasim me të njëjtët muaj të një viti më parë, raporton Monitor. Sipas të dhënave të INSTAT, në muajin nëntor, hynë në Shqipëri rreth 69 mijë shtetas nga Kosova, nga 93 mijë në të njëjtin muaj të një viti më parë, me një tkurrje të ndjeshme prej 27%, ose rreth 25 mijë persona më pak. Edhe në tetor numri i tyre kishte rënë me 11%, ose 15 mijë persona më

5.6

MILIONË TURISTË

Në total, për 11-mujorin, Shqipërinë e vizituan gjithsej 5.6 milionë të huaj, me një rritje prej 16.2% me bazë vjetore. Por, në nëntor, hyrjet në total të të huajve ranë me 3.7%, në 247 mijë persona, si rrjedhojë e rënies së dukshme të hyrjeve të shtetasve nga Kosova.

36%

KOSOVARË

Për 11-mujorin, shtetasit nga Kosova zin peshën kryesore, me 36%, ose rreth 2 milionë persona dhe nëse vijon largimi i tyre pritet t'i japë një goditje të rëndë turizmit vendës, sidomos në zonën e Durrësit, që është destinacioni kryesor i tyre.

pak, pra 40 mijë hyrje më pak të shtetasve nga Kosova vetëm për dy muaj. Përjashtuar tetorin dhe nëntorin, fluksi i hyrjes së shtetasve nga Kosova kishte qenë shumë i lartë. Për 10 mujorin, në Shqipëri kanë hyrë 1.9 milionë shtetas nga Kosova, me një rritje gati 22% me bazë vjetore. Ndërsa në mes të muajit shtator filloi aplikimi i takës së rrugës, prej 5 euro për një veturë, që duket se ka ndikuar në frenimin e lëvizjes së shtetasve nga Kosova, që edhe në periudhën e dimrit vijon për fundjavë në Shqipëri, këtë vit të favorizuar dhe nga moti relativisht i ngrohtë.



EMIGRANTËT NË GREQI LIGJET E REJA

Procedura/ Nënshtetësia për të rinjtë që kanë lindur apo shkollohen në shtetin helen

Voltiza Duro

Të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë në Greqi, në 4 ditët e fundit të këtij viti nuk do të kenë mundësi të aplikojnë për pasaporta apo t'i marrin ato nga zyra përkatëse. Njoftimi është bërë ditën e djeshme nga ambasada shqiptare në shtetin helen, e cila thekson se kjo ndërpreje e shërbimit do të bëhet për shkak të mbylljes së procedurës së fundvitit. "Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, njofton se më 28 (e premte) dhe 31 dhjetor (e hënë) 2018, nuk do të mund të bëhen aplikime për pasaporta si dhe shpërndarje të tyre nga Zyra e pasaportave, për shkak të mbylljes së procedurës të fundvitit për inventarizimin e tyre. Për veprimet të tjera konsullore, Zyra konsullore do të funksionojë normalisht në datat e sipërpërmendura. Faleminderit për mirëkuptimin dhe Gëzuar festat!", -bën me dije ambasada.

VENDIMI PËR "VEVEOSIN"

Ashtu si në vitet e kaluar, Ministria e Mbrojtjes së Qytetarit në Greqi ka firmosur urdhrin që mundëson dhe për 365 ditë të tjera mundësinë e shkuarjes në Shqipëri dhe të kthimit pa problem sërish në shtetin helen, për gjithë emigrantët që nuk kanë marrë ende lejen e qëndrimit. Si gjithmonë, bëhet fjalë për ata emigrantë që kanë dorëzuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm, por që për arsye që lidhen me funksionimin e shërbimeve shtetërore, leja e qëndrimit nuk u ka dalë akoma. Të drejtën e kthimit pa problem në Greqi e kanë edhe ata që kanë dalë gjatë vitit 2018 dhe ndaj aplikimit të tyre nuk ka dalë përgjigje refuzuese apo vendim për anulimin e lejes. "Me vendim të ministres së Mbrojtjes së Qytetarit, Olga Gerovasilis, dhe me qëllim që të lehtësohen emigrantët që u nënshtrohen dispozitave të nenit 8, paragrafi 7 dhe nenit 9 paragrafi 4 të ligjit 4251/2014, lejohet gjatë periudhës kohore nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2019, dalja dhe kthimi i tyre në Greqi, përderisa kanë dalë nga Greqia gjatë periudhës së lartpërmendur dhe vërtetimi (veveosi) i dispozitimit apo vërtetimi i posaçëm që parashikohet nga dispozitat e mësipërme, është në fuqi.

Gjatë kohës së vlefshmërisë së këtij vendimi (nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019), u ofrohet mundësia gjithë shtetasve të huaj, pavarësisht

Shqiptarët në Greqi, vendimi i ri për "Veveosin", kush përfiton

Si mund të ktheheni në Shqipëri kur s'keni leje qëndrimi



PËRFITUESIT E VEVEOSIT

Shtetasit e huaj të që përfitojnë nga ky vendim, në momentin e rikthimit të tyre në Greqi, duhet të disponojnë:

- Pasaportë apo dokument tjetër udhëtimi, që njihet nga Greqia, dhe janë të vlefshme.
- Vërtetimin se kanë depozituar gjithë dokumentet e nevojshme për marrjen apo rinovimin e lejes së qëndrimit, në bazë të dispozitave përkatëse të nenit 8 paragrafi 7 dhe nenit 9 paragrafi 4 të ligjit 4251/2014, ose
- Vërtetimin e posaçëm të qëndrimit të ligjshëm, në bazë të dispozitave të nenit 25 të ligjit 4251/2014.

100
6

EURO TARIFA

Aplikimi për marrjen e nënshtetësisë greke bëhet në periferinë apo bashkinë e vendbanimit e ky aplikim kushton 100 euro për të gjithë të interesuarit që duan të marrin pasaportën helene.

MUAJ PRITJE

Përgjigjia lidhur me pranimin apo jo të kërkesës për nënshtetësinë greke, jepet pas 6 muajsh, çka konsiderohet si ende si një vonesë e madhe për emigrantët shqiptarë që jetojnë në shtetin helen.

DOKUMENTACIONI PËR NËNSHTETËSINË

- Formulari i aplikimit për nënshtetësinë, që plotësohet nga prindërit
- Certifikatë lindjeje e fëmijës nga periferia \ bashkia.
- Certifikatë martesë e prindërve, e përkthyer në gjuhën greke, ose në rastin që martesë u bë në Greqi, certifikatë martesë nga shteti grek.
- Lejet e qëndrimit të prindërve.
- Njeri nga prindërit duhet të ketë leje qëndrimi:
- Të brezit të dytë, ose
- Pa afat (aoristu) ose
- 10 vjeçare ose
- refugjati (prosfiga) ose
- Leje qëndrimi rezidenti afatgjatë ose
- në rast që jeni i mbrojtur nga shteti ose
- personi pa shtetësi ose
- me leje qëndrimi të përkohshme si pjesëtar i familjes së shtetasit grek, ose
- qytetar i BE-së, ose
- kartë homogjeni, ose
- me buletin qëndrimi të përkohshëm si qytetar i BE-së.
- Pasaportat e prindërve me përkthim zyrtar.
- Vërtetim regjistrimi në klasën e parë në shkollën fillore Greke (jepet nga drejtori i shkollës)

vërtetimin e posaçëm të qëndrimit të ligjshëm, në bazë të dispozitave të nenit 25 të ligjit 4251/2014. "Vihet

në dukje se mundësia e daljes dhe e rikthimit nuk u ofrohet poseduesve të vërtetimit të posaçëm të qëndrimit të ligjshëm, që u dha në bazë të nenit 25 paragrafi 5 të ligjit 4251/2014", - sqarohet në njoftimin e ministrisë së Mbrojtjes së Qytetarit.

NËNSHTETËSIA GREKE

Nënshtetësia greke mund të merret më lehtë nga të rinjtë që kanë lindur apo shkollohen në Greqi që prej korrikut të vitit 2015 me miratimin e ligjit 4332/2015. Ndërkohë nuk kanë të drejtë të aplikojnë për nënshtetësinë greke ata të rinj shqiptarë, prindërit e të cilëve nuk kanë leje qëndrimi ose kanë leje qëndrimi afatshkurtër.

Edhe nëse asnjë nga të dy prindërit e fëmijës nuk ka plotësuar 5 vjet me leje qëndrimi në Greqi para lindjes së fëmijës, ose 10 vjet gjithsej përpara ose pas lindjes së fëmijës; i riu nuk mund të aplikojë për nënshtetësi greke. Ndërkohë aplikimi për ata që plotësojnë kushtet mund të kryhet nga momenti që fëmija regjistrohet në klasën e parë të shkollës fillore.

DOKUMENTET PËR NËNSHTETËSINË

Të rinjtë shqiptarë që kanë lindur apo shkollohen në Greqi dhe plotësojnë kriteret duhet të dorëzojnë dokumentacionin për t'u marrë në shqyrtim kërkesa e tyre. Përkatësisht ata duhet të paraqesin formularin e aplikimit për nënshtetësinë,

që plotësohet nga prindërit; certifikatë lindjeje të fëmijës nga periferia \ bashkia; certifikatë martesë e prindërve, e përkthyer në gjuhën greke, ose në rastin që martesë u bë në Greqi, certifikatë martesë nga shteti grek si dhe lejet e qëndrimit të prindërve. Njëri nga prindërit duhet të ketë leje qëndrimi: të brezit të dytë; pa afat (aoristu); 10-vjeçare; refugjati (prosfiga); leje qëndrimi rezidenti afatgjatë ose në rast që është i mbrojtur nga shteti ose personi pa shtetësi ose me leje qëndrimi të përkohshme si pjesëtar i familjes së shtetasit grek, ose qytetar i BE-së, ose ka kartë homogjeni, ose ka buletin qëndrimi të përkohshëm si qytetar i BE-së. Gjithashtu, duhen dorëzuar edhe pasaportat e prindërve me përkthim zyrtar si dhe një vërtetim regjistrimi në klasën e parë në shkollën fillore Greke i cili jepet nga drejtori i shkollës. Aplikimi për marrjen e nënshtetësisë greke bëhet në periferinë apo bashkinë e vendbanimit e ky aplikim kushton 100 euro për të gjithë të interesuarit që duan të marrin pasaportën helene. Ndërkohë përgjigjia lidhur me pranimin apo jo të kërkesës për nënshtetësinë greke, jepet pas 6 muajsh, çka konsiderohet si ende si një vonesë e madhe për emigrantët shqiptarë që jetojnë në shtetin helen.

Ministrja Manastirliu: Ja masat që kemi marrë

Spitalet dhe Urgjencat Mjekësore, në gatishmëri për festat e fundvitit


Në një kohë që festat e fundvitit po afrojnë, spitalet dhe Urgjencat Mjekësore do të jenë në gatishmëri 24 orë për të qenë në shërbim të qytetarëve gjithë kohës. Kjo deklaratë u bë ditën e djeshme nga Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila festoi vigjiljen e Krishtlindjes me fëmijët e shtruar në Pediatri në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë të gjitha masat për të siguruar shërbim 24 orë në ditët e festave, me personel të shtuar në urgjen-

cat e spitaleve", -tha Manastirliu. **URDHRI I MSHMS** Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë për gatishmërinë gjatë festave të fundvitit parashikon edhe sigurimin e barnave dhe materialeve mjekësore shtesë për çdo emergjencë. Gjithashtu, në ditët e festave vendoset në gatishmëri edhe shërbimi i autoambulancave dhe Njësisë së Helikopterëve. Është përcaktuar edhe lista e mjekëve "on call" për çdo spital, pra që do jenë në gatishmëri për çdo situatë

emergjente. Festës në Pediatri në QSUT-së ju bashkua edhe administratori me ekipin e OShEE-së me dhuratat për të gjithë fëmijët. Aktorët e "Portokallisë", balerinë profesionistë dhe animatorë e personazhe të dashur për fëmijët krijuan atmosferë festive me dhuratat e kërcime në të gjitha repartet e Pediatri-së. Ministria Manastirliu i ftoi të gjithë për të qenë më shumë solidarë në këto ditë të festave të fundvitit me ata që kanë më shumë nevojë.

MASAT

"Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë për gatishmërinë gjatë festave të fundvitit parashikon edhe sigurimin e barnave dhe materialeve mjekësore shtesë për çdo emergjencë. Gjithashtu, në ditët e festave vendoset në gatishmëri edhe shërbimi i autoambulancave dhe Njësisë së Helikopterëve.



Dje ministrja Manastirliu në Pediatri

Qeveria: Pagesën e marrin familjet në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuar

Voltiza Duro

Të gjitha familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe nga ajo e paaftësisë do të marrin një shpërblim prej 30 mijë lekësh të vjetra me rastin e festave të fundvitit për 2018-ën. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka hyrë menjëherë në fuqi ditën e djeshme, pas botimit në Fletoren Zyrtare, miratuar nga zv. kryeministria Senida Mesi. Nga paketa e solidaritetit e fundvitit të miratuar nga qeveria do të përfitojnë 62,640 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 69 000 persona me aftësi të kufizuara. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi: Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë kompensohen financiarisht, për vitin 2018, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive përkatëse", theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

KATEGORITË PËRFITUESE

Shpërblimi prej 30 mijë lekësh të vjetra, është parashikuar të shpërndahet për disa kategori të veçanta. Përkatësisht këtë masë kompensimi nga shteti do ta marrin: familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike; familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3,

Miratohet shpërblimi prej 30 mijë lekësh për rreth 132 mijë persona

Zbardhen 4 kategoritë e veçanta që e përfitojnë



Foto Ilustruese

4 KATEGORITË PËRFITUESE:

Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë të cilët do të përfitojnë shpërblimin e fundvitit për vitin 2018 janë:

- a) Familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;
- b) Familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar;
- c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar;
- ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar.



Faksimile e vendimit

397

MILIONË, FONDI

"Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 147 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë dhe përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, miratuar për vitin 2018", - theksohet në Fletoren Zyrtare.

të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar. Gjithashtu, përfitues të shpërblimit prej 30 mijë lekësh të vjetra janë edhe individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar; si dhe individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar.

ZBATIMI I VENDIMIT

"Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 147 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mil-

ionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë dhe përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, miratuar për vitin 2018. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Disa ditë më parë, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu u shpreh se kjo paketë solidariteti konfirmim edhe njëherë vëmendjen dhe përkujdesin e qeverisë për ata që kanë nevojë për përkujdes dhe

mbështetje në këtë prag festash. "Çdo familje përfituese e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara do të përfitojnë 3 mijë lekë shpërblim, me rastin e festave të fundvitit. Kjo paketë solidariteti konfirmim edhe njëherë vëmendjen dhe përkujdesin e qeverisë për ata që kanë nevojë për përkujdes dhe mbështetje në këtë prag festash", tha Ministria Manastirliu duke prezantuar paketën e fundvitit.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT
"AIRFIELD 2020" PROJECT
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit".

1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist Financë/Buxheti" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST FINANÇË/BUXHETI":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

3. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist i Burimeve Njerëzore" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST BURIME NJERËZORE":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME:

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga formatet e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notorizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Rrëfihet këngëtari: Nuk kam shkelur kurrë nëpër gishtat e ndokujt, rivalitete ka kudo

Genc Salihu:

Kam refuzuar të këndoj 'playback', vajza do ndjekë rrugën time

"Letërsia dhe muzika ma mbushin shpirtin plot"

Egla Xhemali

Muzika është formë e veçantë e arti, e të ndjerit deri në grimca ndryshimin e beftë emocional. Padyshim që nuk ka ndonjë formulë të caktuar për ta kufizuar nocionin muzikë me një përkufizim të thjeshtë e aq më tepër të shpejtë. Ai ia ka kushtuar gjithë energjinë e tij artit në përgjithësi e muzikës në veçanti. Një rrugëtim plot të papritura, se këtu qëndron edhe bukuria e skenës, vite intensive me punë dhe projekte që publiku i ka duartrokatur, dher suksesit të hapura për madhësinë e gjësë që me mund e ka ndërtuar, artist i dashur nga mbarë shqiptarët, përtej shkëlqimit të televizionit, njeri i thjeshtë me shpirtin plot ngjyra. E kemi fjalën për Genc Salihun, që shumëkush e mban mend për trainer të "The voice of Albania" dhe produksionet muzikore që kanë lënë gjurmë të patjetërsueshme të publiku. Genci vjen ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare" për të na rrëfyer udhën e gjatë, por të veçantë nëpër muzikë, projektet që ka në duar, pasionin e madh që ka për letërsinë, për domethënie e emrit të së bijës, aventurat e rrezikshme dhe dimensionet



e pafundme që ofron tregu muzikor. Salihu e sheh muzikën të ecë në hapa të mbarë dhe u gëzohet sukseseve të artistëve që kanë dalë tani imë përtej kufijve. Përgjigje që diellojnë edhe ditët më të zymta të dimrit nga një artist, që mund të themi me plot gojë se e ka shpirtin të shenjtëruar.

Ka vite që jeni në skenë. Çfarë ka ndryshuar në muzikën shqiptare që prej daljes suaj të parë?

Dalja ime e parë ka qenë në vitin '95. Mund të them se skena ka ndryshuar mjaft që atëherë. Së pari, globalisht, muzika që dëgjohej sot është diçka krejt tjetër. Hip-hop-i dominon totalisht dhe i ka

infiltruar stilet ngjashëm si roku mes viteve '60-'00, gjë që nuk më pengon aspak, përkundrazi, mendoj se kishte ardhur koha për ndryshim. Pastaj, meqë po flasim lokalisht, televizionet në Shqipëri në 15 vitet e fundit kanë bërë shumë për t'u profesionalizuar dhe si rezultat, ka kohë që kemi programe cilësore të muzikës 'live', gjë që ka munguar deri shumë vonë. Mendoj se që nga koha e sistemit të vjetër, ndoshta është hera e parë që po e shohim skenën tonë muzikore të marrë pak formë, ta ketë një frymë të vetën, pra të fillojë ta marrë veten nga kaosin në të cilin ishte futur gjatë viteve '90, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri. Suksesit i Ritës dhe Duas e shumëkujt tjetër, besoj po ashtu kanë qenë një burim frymëzimi. Por edhe, thjesht, kanë ardhur gjenerata të reja dhe po vënë rregullat të reja. 'Neë rules!' Megjithatë, duhet thënë që ka akoma shumë punë për të bërë, sepse kjo ç'ka kemi është shumë fillestare dhe mund të humbet lehtësisht. **Kënga që e këndon vazhdimisht?**

Një këngë e një grupi shumë të lezetshëm, të vjetër, nga Kosova, që quheshin "Skofia-aret". Ata këndonin këngë qytetare, shpesh korçare, por edhe kishin këngë origjinale, me sa kujtoj. Kënga quhet "Erëmiria" dhe i këndohet vajzës së vogël, fëmijë, nga babai. 'Je e vogël ti akoma/ prandaj luan nëpër dhoma/ do të rritet fëmija/ prandaj qeshin sytë e mija/ gaz e dritë që ka shtëpia'. etj. M'i sjell lotët çdo herë.

Ka kohë që nuk shohim ndonjë videoklip tuajin. **Keni në duar ndonjë projekt?**

Për momentin, bashkë me kolegun dhe mikun tim Florent Boshnjakun, jemi duke e bërë programin festiv për televizionin T7, një medium i ri në Kosovë. Duam t'i sjellim këngët e vjetra kosovare, ato që na e kanë ndriçuar rrugën, apo të paktën një pjesë të tyre, në një format 'live' me ansambël të zgjeruar, të kënduara nga disa prej këngëtarëve më të njohur dhe të dashur që vijnë nga



të gjitha zhanret. Jam entuziast, sepse xhirimet kanë dalë shumë bukur. Përndryshe, duhet të më prisni edhe pak kohë për albumin tim të radhës, për të cilin premtoj se do të jetë interesant. Profesioniu juaj krijon dhe rivalitete. Sa i keni ndjerë ato? E vërtetë, skena është plot

rivalitete gjithmonë dhe gjithkund. Nëse flas për veten, të them të drejtën, jeta ime profesionale është e mërzitshme në këtë fushë, sepse unë vetë nëpërmjet muzikës sime dhe mënyrës se si e plasoj atë, e kam marrë një pozicion të tillë në skenë që, nëpërmjet mo-



Xhensila Murtezaj i lë të gjithë pa fjalë, kaq në formë nuk e keni parë kurrë

Këngëtarja Xhensila Myrtezaj duket më në formë se kurrë në foton e fundit që ka publikuar në rrjete sociale. Në këtë imazh të publikuar në story e shohim Xhensilën të veshur mjaft thjesht dhe thujse pa tualet. Që pas lindjes së Ajkës, Xhensila duket se ka rifituar edhe njëherë format e saj fizike. Së shpejti pritet t'i kthehet muzikës me një bashkëpunim me kantautorin Pirro Çako.



Atmosfera e festave në shtëpinë e Adelina's, ja si uron ajo fansat

Bukuroshja Adelina Tahiri ka postuar një video të mrekullueshme të Jonit Tahiri ka uruar për Krishtlindje me një video të djalit. Në llogarinë e saj në 'Instagram', Adelina Tahiri e ka publikuar një video në të cilën shihet Joni duke u argëtuar në një ambient tejet festiv. "Gëzuar Krishtlindjet", ka shkruar ajo pranë postimit. Kujtojmë se Adelina ka një kohë që nuk ka publikuar ndonjë projekt muzikor dhe është fokusuar në familjen e saj dhe rritjen e djalit



spjesëmarrjes në shumë prej segmenteve të saj nuk më bie as të shkëlqepër gishtat e ndokujt. Për mua, nëse flasim specifikisht për "karrierën", sfida gjithmonë ka qenë mbijetesa në skenë, duke i injoruar 90% të trajtave dhe të përmbajtjes së saj. Një shembull do të ishte refuzimi i 'playback'-ut. Kjo ka qenë arsyeja pse nuk kam marrë pjesë në festivale dhe programe festive dhe ka qenë gjithmonë aventurë të gjenden mënyra alternative

për t'iu qasur publikut. Por, viteve të fundit gjithçka është më mirë, sepse ka pas avancime në skenë dhe unë personalisht ndihem më rahat se në të kaluarën. **Një shpirt i bashkëlidhur bukur me artin. Si erdhi "Plane për jetë"?** Letërsia, në veçanti poezia, kanë qenë gjithmonë aty, qysh nga fëmijëria e hershme. Në fakt, dëshira ime e parë ka qenë të bëhem shkrimtar, pastaj shitës bibliotash në autobus dhe krejt

në fund muzika. Por, ja, ashtu janë zhvilluar gjërat dhe poezia ka mbetur anash, e kam praktikuar vetëm privatisht. Megjithatë, në vitin 2013 më erdhi një ide për ta rrumbullakosur një libërth poetik, me një koncept të caktuar dhe fillova ta gdhend. Është projekti më i dashur që kam punuar ndonjëherë. **Në çfarë dimension i vjen libri dhe muzika tek "Ditë e Nat"?** Krejt natyrshëm. Publiku i

"Ditë e Nat" është rritur me ne. Atë vend e kemi bërë bashkë, kështu që vendosja e tillë e artit në tavolinë tashmë është diçka e përditshme. Plus, ka vende të tjera në Prishtinë tani me koncepte të ngjashme, që kanë synime të ngjashme dhe që angazhohen me komunitetin dhe ne jemi krenarë që e kemi nisur një gjë të tillë, krenarë që i kemi frymëzuar njerëzit të kërkojnë më shumë nga vetja dhe rrethi i tyre. Në 2019-ën na bëhen 10 vite, do ta bëjmë një festë që të mbahet mend!

Ç'domethënie ka emri i vajzës suaj?

Është emër francez, shkurtesë për Marguerite (Margarita). Shkruhet me t në fund, por ia kemi hequr, e kemi bërë shqip. Ka shumë personazhe historike të vërteta e fiktive me këtë emër. Ne ia kemi vënë për faktin e vetëm se na ka tingëlluar bukur. Kur e kemi shqiptuar për herë të parë, thjesht ka goditur në vend. Edhe Margos i pëlqen shumë.

Do e linit muzikën për hir të saj?

Jam në shërbim të saj. Të shpresojmë se nuk do të ma kërkojë më të rëndën. Me sa po shoh e dëgjoj, së shpejti mund të më bashkëngjitet në grup, kështu që jemi mirë.

Pengu më i madh që keni nga rrjedha e kohës?

Më në fund, pas shumë mundimeve, tani vonë kam mësuar se pendimi është gjë e rrezikshme në duar të njoma dhe duhet bërë me kujdes.

Kam bërë paqe me shumëçka. Duhet edhe pak punë.

Aventura më e rrezikshme që keni kaluar?

Nuk e di cila do të mund të ishte. Ndoshta rinia e hershme dekadente, nuk e di. Por, kam përshtypjen se unë futej në aventura të rrezikshme në intervale të caktuara kohore, ndoshta çdo dy vite, apo çdo tre muaj, drejt di! Nganjëherë, e gjithë ideja e të qenit më duket aventurë e rrezikshme. Prapë, nganjëherë, më duket se po bëhem

pasiv dhe depresiv dhe se nuk po i kap të gjitha trampolinat rrugës. Në kohën e fundit e kam kuptuar se sa me fat është ai/ajo që është i dashuruar në një formë artistike, siç është kënga, për shembull dhe e sforcën veten ta mësojë atë, ta zotërojë. Sepse, pastaj, dialogu me veten, që thonë se është diçka esenciale për mendjen e shëndetshme, bëhet shumë konkret, formalizohet, lehtësohet. Nëse dialogu me veten është cilësor, je i gatshëm për cilën do aventurë.



Serbët e Veriut refuzojnë shkrijen me shqiptarët e Kosovës

Kosovë, nis nënshkrimi i petitionit për bashkimin e Mitrovicës

Kreu i komunës Bahtiri: S'tërhiqemi derisa të zbatohet kërkesa

Ditën e djeshme kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, të shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale sot kanë nënshkruar petitionin përmes të cilit kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të nis procedurën për Ndryshim-Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave, me qëllim bashkimin e qytetit të Mitrovicës, por duke mos cenuar në asnjë mënyrë integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Bahtiri theksoi se që nga dita e hënë fillon peticioni për bashkimin e Mitrovicës. "Kërkoj nga ju që të dalim faqebardhë me këtë peticion, e t'i drejtohem në mënyrë legjitime Kuvendit të Kosovës. Nuk do të ketë parti politike, por do të jemi ne për të gjithë, peticioni filloi, dhe në qoftë se dikush do të ketë hamendje që nuk do të realizohet gabon, sepse do të realizohet. Ju lus si qytetar i Mitrovicës që t'i dilni zot vendit tuaj dhe ditën e sotme t'i përgjigjen vullnetarisht dhe masivisht iniciativës sime", - tha Bahtiri.



Kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri

vicës zhvilloi një mbledhje të jashtëzakonshme, ku çështja kryesore ishte kërkesa për bashkimin e veriut të administruar nga serbët me jugun e administruar nga shqiptarët në një njësi të vetme administrative. Mbledhja u zhvillua me kërkesë të kreut të komunës së Mitrovicës Agim Bahtiri, pasi Ministria kosovare e pushtetit lokal refuzoi ta shqyrtojë këtë propozim për të mos shtuar tensionet në veri. "Kjo kërkesë e jona do të zbatohet pikë për pikë. Nuk është iniciativë që e ka marrë kryetari i komunës. Këtë iniciativë e përkrahin shumica e partive në qendër të Republikës së Kosovës", - thotë Agim

Bahtiri, kryetari i komunës së Mitrovicës. Bahtiri është edhe nismëtar i një peticioni që pas grumbullimit të firmave do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës, ku kërkohet ndryshimi i ligjit për ndarjen e Mitrovicës në dy njësi administrative, në jugun e administruar nga shqiptarët dhe veriun nga serbët. "Skemi për të lënë gur pa rrotulluar deri në zbatimin e plotë të kërkesës sonë". Propozimi i Bahtirit erdhi pas dorëheqjes në bllok të krerëve të komunave serbe, në shenjë proteste për vendosjen nga Prishtina të tatimit me 100% të vlerës për produktet serbe. Mes krerëve të dorëhequr ishte edhe Goran Rakić.

AGIM BAHTIRI

"Kërkoj nga ju që të dalim faqebardhë me këtë peticion, e t'i drejtohem në mënyrë legjitime Kuvendit të Kosovës. Nuk do të ketë parti politike, por do të jemi ne për të gjithë, peticioni filloi sot dhe në qoftë se dikush do të ketë hamendje që nuk do të realizohet gabon, sepse do të realizohet. Ju lus si qytetar i Mitrovicës që t'i dilni zot vendit tuaj dhe ditën e sotme t'i përgjigjen vullnetarisht dhe masivisht iniciativës sime", - tha Bahtiri.

Thaçi: Qeveria të rrisë pagesat për ushtarët e ushtrisë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se do të kërkojë nga qeveria që të rrisë pagat për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Tani pasi e themeluan Ushtrinë, të gjithë kemi një unanimitet të plotë të mbështetjes së Ushtrisë së Kosovës, të zhvillimit të saj, të punës së saj të mbarë, të realizimit të misionit të tyre. Unë kam vendosur si president i Kosovës, si komandant suprem t'i propozoj qeverisë së Kosovës rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së, që ushtarët, oficerët të kenë një jetë të dinjitetshme. Shpresoj se qeveria do t'i përgjigjet kërkesës sime në mënyrë pozitive", tha presidenti Thaçi. Këto komente, ai i bëri pas një dreke me pjesëtarët e FSK-së. Presidenti Thaçi tha se Ushtria e Kosovës do t'i kontribuojë pages kudo që kërkohet, duke shtuar se shpreson që shumë shpejt ushtarët e Kosovës të mund të marrin pjesë në misionet paqeruajtëse në botë. Kuvendi i Kosovës më 14 dhjetor ka miratuar tri ligje, të cilat mundësohet transformimi i FSK-së në Ushtri. Presidenti Thaçi tha se sapo të arrijnë këto ligje në presidencë, ai do t'i nënshkruajë ato.

Dialogu me Serbinë, qeveria e Kosovës miraton projektligjin

Haradinaj: Ligjit përcakton procedurën vendimmarrëse për marrëveshjen me Beogradin

Ditën e djeshme qeveria e Kosovës ka miratuar projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se ky projektligj në një afat të shkurtër do t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtimin dhe miratim. "Me anë të ligjit do të përcaktohet hierarkia institucionale dhe procedura vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë", tha Haradinaj gjatë mbledhjes së qever-



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

isë së Kosovës. "Po ashtu, ligji rregullon funksionimin e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës për Dialogun me

Serbinë duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e Delegacionit Shtetëror. Mes

tjerash, ligji definojnë qartë edhe ndërlidhjen që Delegacioni Shtetëror mban me institucionet tjera kushtetuese të Republikës

së Kosovës", tha Haradinaj. Institucionet e Kosovës po i bëjnë përgatitjet për fazën finale të bisedimeve me Serbinë, në kuadër të dialogut që po lehtësohet nga Bashkimi Evropian në Bruksel. Sipas Prishtinës zyrtare, synimet janë që në fund të këtij procesi, Kosova dhe Serbia të nënshkruajnë një marrëveshje, e cila do të ishte ligjërisht obligative për të dy shtetet, me anë të së cilës Kosova do të siguronte edhe ulësen e saj në Kombet e Bashkuara. Megjithatë, platforma, ligji dhe ekipi negociator që pritet të marrin edhe miratimin e Kuvendit të Kosovës, nuk e kanë edhe mbështetjen e dy subjekteve më të mëdha opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje.

Mediat serbe: Putin në 'panik', viziton Serbinë në janar

Vladimir Putin, presidenti i Rusisë, do të vizitojë Serbinë më 17 janar të vitit të ardhshëm, ka bërë të ditur presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić. Siç shkruajnë mediat serbe, ndërsa zgjidhja përfundimtare e problemit të Kosovës afrohet, dy fuqitë më të mëdha, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia po luftojnë për dominim në rajon. Pas letres së presidentit amerikan Donald Trump, në të cilën iu bëri thirrje Hashim Thaçit dhe Aleksandar Vučićit për të arritur marrëveshje historike, presidenti rus nuk dëshiron të humbë kohë. "Pasi marrëveshja në Paris më 11 nëntor nuk është arritur përkundër pritjeve, Trump ka parë si shans që të marrë një rol kyç dhe mentorim në negociatave", citon burimet e veta nga qarqet diplomatike, media serbe "Blic.rs". Prandaj, në një letër drejtuar Thaçit ai tha se ai është i gatshëm për të pritur atë dhe Vučićin në Shqipëri e Bardhë, për të festuar për zgjidhjen e problemit. Në një letër dërguar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, presidenti amerikan Donald Trump, ka kërkuar nga lideret në Kosovë që të shfrytëzojnë këtë moment të cilin ai e ka quajtur unik, të flasin me një zë dhe të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Në këtë drejtim, ndër tjerash Trump, i ka shkruar presidentit Thaçi se SHBA-të janë të gatshme që të ndihmojnë në përpjekjet për të arritur një marrëveshje, e cila reflekton në mënyrë të balancuar interesat e Kosovës dhe të Serbisë. Madje, siç është thënë më tej, një marrëveshje e tillë është e arritshme. Në fund, ajo që bie, gjithashtu, në sy është fakti se Trump ka shkruar se pret që në Shqipëri e Bardhë të mirëpresë presidentin Thaçi dhe homologun e tij serb, Aleksandar Vučić, për të festuar atë që do të jetë një marrëveshje historike. Dhe këtë "ngutje" të Putinit, media serbe e quan "panik", për të cilën gjë shkruan se edhe ka vendosur që së shpejti të vizitojë Serbinë. Rusia njihet si mbështetëse e aspiratave të Serbisë. Këtë së fundmi e dëshmoi edhe ambasadori rus në OKB Vasily Nebenja, i cili mbështeti presidentin serb Vučić dhe Serbinë në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së të mbajtur me propozimin e Serbisë, për shkak të formimit të ushtrisë së Kosovës. Ai tha se ndau shqetësimin e shprehur nga presidenti serb dhe theksoi se transformimi i FSK-së në Ushtri të Kosovës është shkelje e Rezolutës 1244 dhe se kërcënon paqen dhe sigurinë në rajon. Ai, gjithashtu, vlerësoi se KFOR-i ishte selektiv në përmbyshjen e mandatit të tij.

Përplasia me kryeministrin izraelit, reagon Erdogan

E akuzoi si pushtues, presidenti turk: Izraeli të llogarisë mëkatet e tij para se të flasë

Vijon përplasia e kryeministrit izraelit Benjamin Netanjahu dhe Presidentit turk Rexhep Tayyip Erdogan, të cilët u përfshinë këtë fundjavë në valë republikash të ashpër në distancë. Të shtunën Netanjahu akuzoi Erdoganin përmasë një postimi në Twitter si pushtues të Qipros Veriore dhe masakruar të kurdëve. "Erdogani - pushtuesi i Qipros Veriore, ushtria e të cilit masakron gra e fëmijë në fshatrat kurde, brenda e jashtë Turqisë nuk duhet t'i bëjë predikime Izraelit", tha Netanjahu. Komenti er-



Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan

REXHEP TAIP ERDOGAN

"Izraeli nuk ka të drejtë të akuzojë askënd pa llogaritur më parë mëkatet e veta, krimet kundër njerëzimit, masakrat dhe shkatërrimet që u ka shkaktuar palestinezëve." Në mbështetje të shefit të tij doli ministri i Jashtëm turk, Mevlut Çavushollu, i cili publikoi foto të dhunës së ushtrisë izraelite ndaj civilëve palestinezë. Ndërsa Netanjahu, po në Twitter akuzoi Erdoganin si diktator anti-semit. Polemikën mes Netanjahut dhe Erdoganit vijojnë prej 1 dekadë për çështjen e Gazës dhe influencës së Iranit në rajon. Por përplasjet e fundit vijnë pas tërheqjes së amerikanëve nga Siria në koordinim me ushtrinë turke, një bashkëpunim që për Izraelin është i papranueshëm.

dhi pasi presidenti turk akuzoi ushtrinë izraelite për masakra ndaj palestinezëve, por Erdogan nuk vonoi me kundërpërgjigjen ndaj Netanjahut. "Izraeli

Shpërthimi i vullkanit, "The Guardian" publikon pamjet e frikshme

Vijon tragjedia, shkon në 373 numri i viktimave të cunamit në Indonezi

Banorët vendës paralajmërohen për përsëritjen e rrezikut

Pas fatkeqësisë së ditës së shtunë, ditën e djeshme "The Guardian" ka publikuar pamjet e shpërthimit të vullkanit Krakatau që shkaktoi cunamin vdekjeprurës në Indonezi. Një shpërthim i vullkanit një ditë para cunamit u filmua nga kamerat e një ekipi të Agjencisë së Burimeve Natyrore në Indonezi. Krakatau ndodhet në ngushticën midis Java dhe Sumatra, që lidhin Oqeanin Indian dhe Detin Java. Autoritetet thanë se cunami i së dielës në Indonezi ishte shkaktuar nga rrëshqitjet e dherave në det të shkaktuara nga shpërthimi i vullkanit, dhe jo nga ndonjë tërmet. Autoritetet indoneziane kanë njoftuar se numri i të vdekurve nga cunami ka shkuar në 373 persona. Ato kanë thënë se vendi mund të goditet nga cunami të tjerë vdekjeprurës pasi vullkani po vazhdon të nxjerrë lavë. Presidenti i Indonezisë, Joko Widodo, e ka urdhëruar Agjencinë e Meteorologjisë që të vendosë detektorë për t'i vërejtur ndryshimet klimatike. Përpos të vdekurve, cunami ka shkaktuar lëndimin e 1459 personave ndërsa 128 njerëz tjerë janë raportuar të zhdukur. Banorët vendas janë këshilluar që të largohen nga bregu i detit, sepse ekziston frika për cunami të tjerë. Ekipetë të shpëtimit i është vështirësuar puna e kërkimit për të mbijetuarit për shkak të rrugëve të bllokuar, ndonëse në zonat më të goditura janë dërguar mjete për ngritjen e peshave të rënda për t'i mbështetur operacionet e kërkimit, shkruan "BBC". Indonezia goditet shpesh



Pamje nga cunami në Indonezi

nga tragjedi të tilla, pasi ndodhet në të ashtuquajturën Unaza e Zjarrit, ku janë të shpeshta vullkanet, tërmetet e cunamet. Ndërkaq banorët e ishullit vullkanik të Indonezisë, Anak Krakatau janë paralajmëruar që të qëndrojnë larg bregdetit për shkak të shqetësimeve se ata mund të përballen me një cunami të ri. Të shtunën, valët gjigante të detit kanë goditur zonat bregdetare të ishujve, Sumatra dhe Java duke lënë të vdekur qindra persona dhe duke plagosur mbi 1,016 të tjerë. Sipas raportimeve, ka mundësi që vullkani është aktivizuar si pasojë e disa rrësh-

qitjeve të dheut nën det, të cilat kanë rezultuar me valë vrasëse. Ndërkohë të dielën ishulli vullkanik Anak Krakatau ka shpërthyer sërisht duke hedhur tym dhe hi. Zëdhënësi i Agjencisë për Menaxhimin e Katastrofave Kombëtare, Sutopo Purwo Nugroho, ka thënë në një konferencë për media se ekziston mundësia e përballjes me një tjetër cunami për shkak të shpërthimeve të vazhdueshme të Anak Krakatau. "Agjencia për Meteorologji, Klimë dhe Gjeofizikë i rekomandon personave që jetojnë afër zonave bregdetare, të pezullojnë të gjitha aktivitetet

detare dhe të qëndrojnë larg brigjeve për një periudhë", ka thënë ai. Sistemi i alarmit në zonat e shkatërruara nga cunami në Indonezi "nuk ishte në funksion që nga viti 2012" për shkak të mungesës së fondeve, akteve të vandalizmit dhe problemeve teknike. Kështu ka denoncuar zëdhënësi i agjencisë për menaxhimin e fatkeqësive, Sutopo Purwo Nugroho. Ekipet e shpëtimit vazhdojnë kërkimet për të zhdukurit nën shi dhe druhet se mund të ketë tërmete të tjera dhe cunami. "Numri i viktimave dhe dëmeve do të vazhdojë të rritet", tha

BILANCI

Autoritetet indoneziane kanë njoftuar se numri i të vdekurve nga cunami ka shkuar në 373 persona. Ato kanë thënë se vendi mund të goditet nga cunami të tjerë vdekjeprurës pasi vullkani po vazhdon të nxjerrë lavë. Presidenti i Indonezisë, Joko Widodo, e ka urdhëruar Agjencinë e Meteorologjisë që të vendosë detektorë për t'i vërejtur ndryshimet klimatike.

zëdhënësi i mbrojtjes civile. Qindra ndërtesa u shkatërruan nga vala 20 metra e gjeneruar nga vullkani de që goditi bregun jugor të Sumatrës dhe bregun lindor të Javas. Presidenti indonezian Joko Widodo do të shkojë në zonat e fatkeqësive. Ndërkohë, "biri i Krakatoa", vullkani Anak, vazhdon të shpërthejë dhe autoritetet indoneziane kanë ftuar edhe sot popullsinë dhe turistët të qëndrojnë larg plazheve nga frika e një vale të dytë shkatërruese të cunamit. Janë të paktën 600 shtëpi të shkatërruara, 9 hotele të dëmtuara rëndë: pothuajse 12,000 njerëz të zhvendosur.

SHKURT

Makina e pastrimit të borës përplas këmbësoren për vdekje

Një grua 43 vjeçe, gjëti vdekjen e menjëhershme, pasi një borë pastruese doli jashtë kontrollit. Ngjarja tragjike ka ndodhur në qytetin Petropavlovsk-Kamchatky në Rusi. Pamjet e tmerrshme tregojnë momentin kur shoferi që drejtonte automjetin e pastrimit të borës humbet kontrollin dhe përfundon në stacionin e autobusit, raporton Daily Mail. Video është filmuar nga kamera e një automjeti që ishte duke kaluar në momentin që ndodhi ngjarja. Dëshmitarët në vendngjarje kanë thënë se ishte e tmerrshme ajo që panë. "Isha aty kur gruaja dha shpirt, ishte një tmerr". Policia e Kamchatky ka konfirmuar vdekjen e këmbësores, pasi kishte marrë plagë të shumta. Shoferi 33-vjeçar që drejtonte makinën e pastrimit është në hetim lidhur me ngjarjen e rëndë. Nga hetimet e deri më tani shpesh mësohet se shkak i aksidentit është humbja e kontrollit të shoferit.

Bruksel, qëllon me armë në restorant, largohet me vrap autori

Një person i paidentifikuar ka qëlluar me breshëri arme në një restorant në qendër të Brukselit në Belgjikë. Autori më pas u largua me shpejtësi nga vendngjarja. Nuk ka raportime për persona të lënduar. Një dëshmitar i tha policisë se autori i dyshuar ka qenë i armatosur me kallashnikov. Ai është shpallur në kërkim dhe po punohet për arrestimin e tij, në mënyrë që të zbardhen motivet. Hetuesit konstatuan në vendngjarje tre vrime të plumbave në dritaren e restorantit.

Dënohet me burg për korrupsion ish-kryeministri pakistanez

Ish-kryeministri pakistanez, Muhammad Nawaz Sharif u dënua me shtatë vjet burg për korrupsion, për rastin e lidhur me çështjen Al-Zia Steel Mills. Gjykatë, gjithashtu, e dënoi atë të paguajë një gjobë prej 25 milionë dollarësh. Rreth ndërtesës së gjykatës u rrit siguria nga frika e përplasjeve me mbështetësit e ish-kryeministrit, të mbledhur jashtë saj. Sharif ishte dënua me 10 vjet korrikun e kaluar, pastaj u lirua pas një vendimi të Gjykatës së Lartë.

KONKURSI



Galeria kombëtare e pranon: E mbyllëm Onufrin! Kishte humbur nivelin

Fatmira Nikolli

Galeria Kombëtare e Arteve ka pranuar zyrtarisht se e ka mbyllur Onufrin. Përmes një deklaratë zyrtare GKA jep arsyet që sipas saj kanë çuar në këtë vendim që kanë të bëjnë me nivelin e konkursit që ndër vite ka humbur, diferencimin që i është bërë ndër vite artistëve shqiptarë dhe nevojën për një qasje të re.

Prej një viti, Galeria Kombëtare e Arteve që me ligjin e ri merr emrin Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura, është vënë në qendër të kritikave, teksa në drejtim është Erzen Shkololli. Heshtjes së pothuaj një viti, u është shtuar edhe mbyllja e Ekspozitës Ndërkombëtare "Onufri", për çka GKA jep sqarim vetëm për Krishtlindje, datë kur duhej të ishte hapur ekspozita e përvitshme.

Ministria e Kulturës dëshoi ta mbyllte "Onufrin" edhe dy vite më parë. Drejtori i atëhershëm Artan Shabani refuzoi ta merrte si vendim dhe dha dhe arsyet se pse Onufri nuk duhej mbyllur. "Qëndrimi im, edhe si artist, edhe si titullar institucioni, është që një traditë nuk duhet të humbasë, sidomos në Shqipëri. Di që ne e kemi skenën e artit, shpesh edhe të vakët do të thoshja, sepse nuk kemi shumë struktura që promovojnë artin bashkëkohor. Nuk është se në Shqipëri ka një rrjet muzeal për artin bashkëkohor, madje s'ka ende një muze të artit bashkëkohor. Jam për një përgjigje "Po", sa i takon pyetjes suaj. Pra, unë jam që "ONUFRI" të bëhet, të ketë një vazhdimësi. Unë nuk shikoj një arsye që ai të mos bëhet", tha Shabani atëherë për "GSh". Në një vend ku mungon një muze i artit bashkëkohor, e me një skenë të vakët të këtij arti, reflektimi nëse duhet mbajtur apo jo ekspozita dhe konkursi ndërkombëtar i artit pamor "ONUFRI", pat hapur debat atëherë. Në kuadër të këtij reflektimi, një

"Do rikonceptohet që galeria të jetë platformë ndërkombëtare"

tryezë diskutimi u mbajt. Tanimë, zyrtarisht një aktivitet me traditë 20-vjeçare shënon mungese nuk dihet se deri kur. Gjëni më poshtë sqarimin e Galerisë Kombëtare të Arteve.

DEKLARATA E PLOTË

Në kuadër të dinamikave në të cilat zhvillohen shkëmbimet artistiko-kulturore ndërkombëtare sot, dhe si pasojë e problematikave që janë shfaqur ndër vite me Ekspozitën Ndërkombëtare të Arteve Pamore "Onufri", aktivitet ky që ka patur mision primar realizimin

e këtij shkëmbimi në Shqipëri, Galeria Kombëtare e Arteve ka vendosur në mbylljen e "Onufrit" dhe rikonceptimin e programit të saj të përgjithshëm artistik.

"Onufri" u krijua në fund të viteve '90-të si një domosdoshmëri e kohës, që do të mundësonte shkëmbimet mes artistëve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë, si dhe për të prezantuar artin e ri bashkëkohor të skenës vendase në kushtet e mungesës së plotë të institucioneve apo iniciativave të pavarura. Për këtë arsye, për vite me

rradhë "Onufri" mbajti peshën kryesore të shkëmbimit kulturor ndërkombëtar në artet pamore, duke i dhënë kështu një shtysë edhe metodave të reja të punës dhe praktikave artistike. Me kalimin e viteve skena është pasuruar edhe me një numër në rritje iniciativash të pavarura që gjithmonë e më shumë kanë për qëllim shkëmbimin mes artistëve vendas dhe atyre ndërkombëtarë. Nga ana tjetër, shumë edicione të

"Onufrit" nuk kanë pasur nivelin e duhur të organizimit për t'i prezantuar denjësisht artistët. Bashkëveprimi midis artistëve shqiptarë dhe të huaj në kuadër të këtyre edicioneve ka qenë pothuajse fiktiv, pasi shumë nga artistët e huaj pjesëmarrës të "Onufrit"

nuk kanë qenë të pranishëm gjatë ditëve të organizimit të ekspozitës. Gjithashtu, në të shumtat e rasteve është aplikuar një qasje e padrejtë ndaj artistëve shqiptarë të cilët duhet të kalonin fazën e përzgjedhjes, kundrejt artistëve të huaj që ftoheshin direkt nga kuratori. Për rrjedhojë edhe interesi i publikut ndaj kësaj ekspozite si dhe vet vlera e këtij aktiviteti janë zbehur me kohë.

Ky aktivitet që fillimisht lindi si një nevojë për të rritur ndërvlerimin mes skenës vendase dhe asaj ndërkombëtare vlerësohet se tashmë e ka përmbushur misionin e tij. Zhvillimi i situatës artistike në vendin tonë, por edhe zhvillimet më të fundit të artit bashkëkohor në përgjithësi, nuk përkujtojnë më formën e organizimit dhe strukturën që "Onufri" ka ndjekur gjatë viteve. Anëtarët e Bordit Artistik dhe drejtori i GKA-së z. Erzen Shkololli ndajnë mendimin se GKA ka nevojë për një formatim dhe një qasje të re pune që do të jetë në hap me zhvillimet e reja në artin bashkëkohor dhe që reflektojnë ndryshimet thelbësore socio-politike në Shqipëri, rajon e më gjerë. GKA duhet të zhvillojë veprimtaritë e saj të radhës, të cilat prezantojnë sa më mirë artistët në ekspozita ndërkombëtare tematike e të kuruara, dhe që vijnë si rezultat i një pune të pasur kërkimore. Ky rikonceptim i programit artistik synon që ta kthejë Galerinë në një platformë të rëndësishme për shkëmbimin kulturor në nivel ndërkombëtar.

Bordit Artistik i Galerisë Kombëtare të Arteve përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë vijon:

Eleni Laperi (Kryetare), Edi Muka, Ornela Vorpsi, Zef Paci, Luçjan Bedeni, Sofjan Jaupaj, Xhoana Agolli. Anëtarët e këtij Bordi ranë dakord për mbylljen e "Onufrit" gjatë mbledhjes së tyre më datë 11.12.2018, me Vendim nr. 308/2. Ministria e Kulturës shprehu dakordësinë e saj mbi këtë vendim, në respektim të pavarësisë së gjykimit të Bordit Artistik të Galerisë Kombëtare e Arteve.



“
"Onufri" u krijua në fund të viteve '90-të si një domosdoshmëri e kohës, që do të mundësonte shkëmbimet mes artistëve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë, si dhe për të prezantuar artin e ri bashkëkohor të skenës vendase në kushtet e mungesës së plotë të institucioneve apo iniciativave të pavarura.

IN MEMORIAM

Fatmira Nikolli

Dhe Dom Gjergji tha: Krishtlindja që na la Atjoni

Kur vjen Krishtlindja, kjo festë katolike e gëzimit në të gjithë botën, e njerëzimit dhe e gjithkujt, festë dhe për ata/atë që s'janë të krishterë apo s'e dinë, tek mua bën që të më kujtohet dhe diçka tjetër, që i përket botës time e jo vetëm, e thjeshtë, por domethënëse, që më mallëngjen me bukurinë, që na e zbuloi me një shkrim të vetin Dom Gjergj Meta, ipeshkv i Rrëshenit tani, me titullin "Krishtlindja që na la Atjoni".

Jam një nga ata që e duan shumë dhe e çmojnë Atjonin, dëshiroj të mbetem anonim, nga që po tregoj thjesht mallin për atë, tani që ka katër vjet që ka ikur në qiell, e di që do të donin ta tregonin dhe shoqe e shokë të tjerë të tij, ja, po e bëj unë dhe për ata, madje as unë, thjesht po sjell ca grimca rrëfimesh, të nxjerra nga libri i Atjonit, "Për atë që dua(m)", e shfletoj dhe ndaloj te parathënia, në atë pjesë, që më është ngulitur që në leximin e parë.

Dom Gjergj Meta, i cili mbajti dhe një meshe për Atjonin në kishën "Shën Luçia" në Durrës, në shkrimin e tij e shikon atë si prurës të Krishtlindjeve të atij viti, (kur doli shkrimi, 25 dhjetor 2014, shën. imi) në mënyrën më moderne, duke u nisur dhe nga ajo që shkruante në "Fb" shoku i Atjonit, Denis, të cilën Dom Gjergj Meta e risjell të plotë:

"...një mbremje pranverë në Milano, te Naviglio, u takuam si bëmish shpesh. Kalon një zonjushë duke na kërkuar një shami se i ishte këputur sandalja (donte ta lidhte) dhe ishte detyruar të ecte zbatuar... 'keni një shami?' - na thotë vajza, - më vjen shume turp të ecti zbatuar mes njerëzve që më shofin si të isha e çmendur!..."

"Zonjushë, shami nuk kemi, por ju premtoj se kureshtjen dhe habinë e njerëzve do e mar unë për sipër" - thotë Atjoni flokë kaçub-ja... heq këpuçet bashkë me corapet (të lidhura bashkë i hedh mbi njerin sup te tij) dhe e shoqëron vajzën deri te taksitë duke qeshur dhe duke i buzëqeshur çdo shikimi kureshtar... 'Shifemi më pas, plak'o' - më the dhe tërë rruga atë natë buzëqeshi me mirësi dhe alegrë prej gjestit tënd. Kështu do e mbaj mend gjithmonë ikjen tënde, duke lënë pas vetëm alegrë dhe adhurim për gjigandin e bukur..."

Përtej afekcionit njerëzor që ka shprehur shoku i tij, unë këtu gjea historinë më të bukur të këtij viti. Fatmirësisht në këtë stallë ka ende njerëz që bëjnë të bukur dhe e ndriçojnë atë. Krishtlindja është pikërisht kjo: Hyji që ecën me njerëzit duke u bërë si ata e duke marrë shpesh mbi vete përqeshjen dhe talljen e njerëzve për të mbrojtur ata që kanë nevojë më shumë."

Shkëlqyer, them prapë. Mezi lexoj prej lotëve që më mbushin sytë. Ndjej engjëj pranë. Dhe engjëlli Gabriel i tha Maries se ajo do të ishte nëna e Birit të Perëndisë...

Por dua të vazhdoj me Atjonin tani, që më jep ngazëllimin e



Copëza rrëfimesh dhe mendime për një engjëll në një dhjetor të trishtë

Krishtlindjes. Shfletoj "Për atë që dua(m)", ja, në kreun e fundit janë renditur ç'kanë thënë ata që e kanë njohur Atjonin, një pjesë e mirë e quan "engjëll" dhe, duke qenë se jemi në të kremte, më vjen të rendis disa. Po e filloj me ç'kanë shkruar në një letër të tyre bashkëshortët shkrimtarë, Helena dhe Ismail Kadare:

"...E kam ende të gjallë buzëqeshjen e tij të çiltër, kokën e bukur plot kaçurele të zinj, tek vraponte galerive të Muzeut të Arteve në Vjenë, për të kapur dhe kuptuar gjithçka mahnitëse të atyre tablove të mjeshtërve të mëdhenj, që po vizitonim së bashku. I them këto se nuk është diçka e zakonshme për një femijë të moshës së tij ai pasion dhe ajo kureshtje, për të mësuar njëherësh dhe sa më shpejt gjithçka.

Kjo fytyrë e bukur engjëllorë, që nuk e kisha parë në këto vite, m'u shfaq befas në faqet e gazetave, si një britmë e ububushme. Ai djali i vogël, bërë tani një djalosh i pasëm e gjithë nur, nuk ishte më! Ajo krijesë e mrekullueshme pra, ishte bërë për qiellin, jo për këtë botë... Dhe m'u kujtua shprehja e vjetër: Zoti zgjedh, nuk mbledh!

Ishte drita dhe forca shprehëse e kësaj fotoje që e bëri vajzën tonë, Gresën, të vijë e tronditur e të më thotë: E kam parë Edën, gruan e Visarit vite më parë, kur ishte me barrë me këtë djalë... Sytë e Edës, shtoi ajo, nuk i harroj, sepse kishin diçka prej Madone. Të bukur, me

një tis të lehtë brenda tyre. Tisi i misterit të amësisë, do të thoja unë. Gjej këtë pjezës, kur Atjoni është femijë, tre vjeç e gjysmë:

Po në këtë moshë vizatoi me lapsa me ngjyra një Nënë Terezë, të cilën dhe do ta takonte më vonë. Kur ai portret femënor u fut në një botim italian, do të shkruante dhe gazeta më e madhe e Vatikanit. Ai vizatim, sipas autorit të shkrimit Giampaolo Mattei, "është një 'strategji politike' e madhe, shumë më serioze e më konkrete se ato të udhëhequra me forcën e armëve" ("Osservatore Romano", 10 korrik 1999).

Ja, s'qenka forca e armëve më e forta. Do ta ndryshojmë botën me buzëqeshje, thoshte Atjoni. Po ç'thonë të tjerët për atë?

"...një engjëll të bukur që na fali gjithmonë dashuri, ngrohtësi e miqësi, që e bëri miqësinë tonë më të vyer, që i bëri takimet tona më të pashlyeshme!...Besonim shumë tek Atjoni, shikonim shumë prej projekteve tona të parralizuara tek ai. Sepse e donim shumë dhe ai na donte shumë. Një dashuri, një kujdes, një dhembshuri e pastër..." kujton intelektualin evropian, kritik arti dhe përkthyes në Bukuresht, Luan Topçiu. Ndërsa shkrimtari Preç Zogaj duket sikur e vazhdon: "...zbuluam pa teprime atë që thotë poeti suedez Traströmer se 'pa e ditur ishte hyjnor'..."

...engjëll që e kam njohur... me kaq mjaftohet shkrimtari Egerem Basha, po kështu dhe studiuesja

Marisa Kerbizi: "...Kerubin i mençur dhe i bukur... engjëll që e njohëm në tokë... shprehet shkrimtari grek Dino Kubatis dhe vazhdon: na ka ngulur e skallitur buzëqeshja e tij magjike, që i bënte njerëzit për vete, kultura e tij, njohuritë e tij për moshën e tij të re dhe dashurinë e respektin që tregonte për të tjerët..."

Albanologu më i madh i ditëve tona, kanadezi Robert Elsie, bën një si përkufizim kështu: Nuk kam takuar një të ri kaq të mirë, kaq fisnik dhe kaq të dashur në Shqipëri, sa Atjoni.

...me shqetësimë përtej moshës së tij. Ndoshta dhe me një idealizëm që vetëm moshë e tij mund ta ketë... shkruan gazetari Alfred Lela, ai që e botoi i pari Atjonin.

Ndal te një detaj tjetër: Atjoni do të tregonte për Parisin e vonë të pas mesnatës, kur nuk kishte zbardhur ende e rrugët ishin bosh dhe, ja, hapet një portë dhe del një vajzë duke qarë, i dola para, pa folur e përqafova dhe ajo s'tha asgjë, më përqafoi, buzëqeshi pak dhe iku duke fshirë lotët...

Të bësh tjetrin të fshijë lotët. A s'është ky një udhëtim prej Krishti? Ka të drejtë Dom Gjergji. Përsëri një histori tjetër, e vogël nga Roma tani:

Një herë, kujtojnë miqtë, në shtëpinë e poetit dhe kritikut të artit Sebastiano Grasso, Atjoni kishte parë një kopicë me insertin kulturor "Lettura" të gazetës më të madhe italiane "Corriere della Sera". Edhe pse jepet falas, u kishte thënë të ftuarve gjatë drekës i zoti i shtëpisë, prapë nuk e marrin sa duhet... Kur ikin, Atjoni i mbarti me vete gazetën e mbetura dhe së bashku me shokën e tij, Olimpian dhe me një mik tjetër ika 70 vjeç, Massimo-n, hipin në tramvajin që i çonte nëpër sh-

tëpira. Udhëtarëve të rastit, ndoca sapo kishin dalë nga puna, të rinj, gra, të moshuar, shamatorë, vetmitarë, në grupe, etj. Atjoni nis dhe u shpërndan insertin kulturor duke u thënë se "un po di 'lettura' non fa male..." (pak 'lexim' nuk ju bën keq...). Të vinte mirë kur i shikoje të gjithë që po e shfletonin duke u bërë më të vëmendshëm. Trami ngjante me një bibliotekë lëvizëse

Atjoni, misionar i leximit, kur dhe vetë sapo e kishte zbuluar "lumturinë e leximit", siç shprehej. Ai ishte i gjithi dashuri.

...Atjoni donte të vinte një banderolë të madhe në sheshin Nënë Tereza në Tiranë, të kapej te një shtyllë në njerin trotuar dhe tek një shtyllë tjetër në trotuarin përballë, ku ai të kishte shkruar me stilin e tij: Të dua L... I love You... Kështu thoshte. Kishte rënë në dashuri... dhe një banderolë e tillë që ta shikonin të gjithë, kishte shumë e më shumë rëndësi se ato të fushatave të partive apo të publiciteve të panareve industriale, etj, gjithmonë sipas tij.

"YLLATJON do të mbetet një dritë e lartë dashurie për çdo shqiptar kudo që jeton. YlliAtjoni e ka më të lehtë t'ju ndriçojë jetën plot dashuri e dritë në vendin e Zotit.", shkruan shkrimtarja shqiptare në Kanada, Eglantina Mandia.

"Libri i Atjonit - testamenti i Tij për Shqipërinë... si Ungjilli për bashkëmoshatarët e tij fatlumë... fari ndriçues i brezit të Tij... i pranishëm përherë në jetën e përditshme të popullit të vet, apo më mirë, të pjesës së tij më të mirë...", na thotë studiuesi Eugjen Merlika. Po, edhe unë ashtu e ndjej.

Me të drejtë thotë shoqja jonë, studentja e atëherëshme Eni Daka: Je shoku im i ngushtë, vëllai im, i dashuri im, babai im, gjithçka-ja ime, tani je dhe engjëlli im mbrojtës. Do e ndryshojmë në botën në emër të Atjonit.

Dhe kthehem atje ku e nisa, te Dom Gjergj Meta. Ajo që tha ai, i ka bërë përshtypje dhe Profesorit arbëresh, në Katedrën e Albanologjisë në Palermo, në Itali:

"...Lexova një shkrim të Dom Gjergji Metës ku gjeta fjalë e kura-jë... një kujtim i gjallë për çdo besimtar. Dom Gjergji kapi te sjellja e Atjonit sensin e thellë të jetesës sonë. Me thjeshtësi të lartë, ky djalë i mësuar me vuajtjet, na tregoi rrugën e pastër të dashurisë njerëzore. Ai si Bir e kishte që te emri fatin e Atit tonë. Ai, djalë, si At i vërtetë, na dha shembuj të rrallë që na kujtojnë paradigmën e vërtetë nëpërmjet së cilës duhet të kemi durim, sidomos në këto prova të padurueshme. Është vështrë të merret me mend, por pikërisht për këtë arsye Atjoni është me ne... i përjetshëm.

Dhe unë përsëris edhe për këtë vit atë që tha si profet Dom Gjergji: Krishtlindja që la Atjoni...

Helena e Ismail Kadare, Matteo Mandalá, Luan Topçiu, Eugjen Merlika

Opinion i Ditës

"Rreziku" nga Ushtria e Kosovës

Nga Zeno Jahaj

(vizon nga faqja 1)

... si e rrezikshme. Siç kanë qenë lexuar në të gjitha kohërat.

Kryeministri i Serbisë imagjnon se formimi i një ushtrie të Kosovës është në kundërshtim me përpjekjet për stabilitetin në Ballkanin e pa qëndrueshëm, madje tha se Beogradi e paska një opsion në tryezë të përdorë 28.000 trupat e saj për të mbrojtur minoritetin serb në Kosovë. Që do të thotë të ripushtojë Kosovën!

Ndërkohë, Rusia e denoncoi lëvizjen politike kosovare, duke kërkuar që ushtria e Kosovës duhet të rishpërbëhet, pasi qenkërka rrezik për rajonin!

Po si mund të bëhet rrezik për stabilitetin në rajon, Ushtria e Kosovës prej 3000-5000 trupash dhe jo 28.000 trupat, tanket dhe bombarduesit e Serbisë?

Bota ka të paktën një dhjetëvjeçar që po e shikon se rrezik për paqen dhe sigurinë nuk përbëjnë ushtritë e deklaruarat zyrtarisht për mbrojtje, por grupet e pa deklaruarat paramilitare. Terrori i këtyre bandave është eminent për shembull në Ukrainë. Bota (fatkeqësisht edhe NATO) po shohin se pushtimi ushtarak me ushtri të pa deklaruarat është kthyer tashmë në doktrinë. Dhe serbët e kanë këtë përvojë, historikisht dhe në kohët moderne, nga spastrimi etnik e deri tek terrori në stadiume futbolli!

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, pat paralajmëruar qeverinë e Kosovës, se vendi do të "ndeshet me pasojat serioze", duke shtuar se "vendimi për të nisur një ndryshim të mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është bërë pa varësisht shqetësimeve të shprehura nga NATO. Të gjitha palët duhet të sigurojnë që vendimi nuk do të rrisë më tej tensionet në rajon". Nëse kjo deklaratë nuk është një shprehje diplomatike apo fryt i presionit evropian, atëherë lind pyetja: Për sa dhjetëvjeçarë do të mbeten në Kosovë trupat e NATO-s?

Akademikët dhe politikanët serbë vetëngushëllohen kur formalisht gjejnë se asnjë akt i vetëm në të drejtën ndërkombëtare nuk u jep kosovarëve të drejtën për të formuar një ushtri. Ndoshta se nuk janë pranuar zyrtarisht si shtet nga komuniteti ndërkombëtar. Por harrojnë një "holles" të vogël; që popujt, për të bërë shtet, në fillim kanë krijuar ushtritë e tyre. Kosova, si cillido shtet serioz, e ka për detyrë të ndërtojë ushtrinë e vet. Se nuk ka shtet pa ushtri, pa mbrojtje. Në fund të ditës, është ushtria, krahas instrumenteve të tjera, që e bën shtetin të diktojë vullnetin apo moralin e tij. Prandaj edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë tjetër optikë kur deklaruan ishte "vetëm e natyrshe për Kosovën si një vend sovran dhe i pavarur, të këtë një aftësi



të vetëmbrojtjes."

Ushtria e Kosovës nuk mund të përbëjë kërcënim. Diplomaci po. Ushtrarakët, aq më tepër ata kosovarë që e bënë luftën, e dinë mirë rrezikun e saj dhe prandaj, edhe vlerën e paqes. Le të kujtojmë se proceset e paqimit në Ballkan filluan më së shumti me paqimin e ushtrive sesa me marrëveshjet e politikanëve. Aq më tepër sot, ushtritë e rregullta, me atributet që kanë marrë, përbëjnë grupin më të madh diplomatik të çdo kombi.

Kosova e ka një histori ushtarake. E kishte UÇK-në. Dhe me këtë histori lufte i ka të gjitha kapacitetet të bëhet një faktor më shumë për paqen.

Por a mund të thirret Ushtria e Kosovës edhe për sigurinë? Patjetër, pse jo. Si çdo ushtri tjetër, edhe ajo mund të thirret për mbështetje brenda ligjit e në zbatimin e ligjit, në operacionet e rendit publik, për kontrollin e kufirit, kontrollin e drogës, hetimin e krimin, operacionet kibernetike, mbledhjen e informacionit e inteligjencës, mbrojtjen civile,

Ushtria e Kosovës nuk mund të përbëjë kërcënim. Diplomaci po. Ushtrarakët, aq më tepër ata kosovarë që e bënë luftën, e dinë mirë rrezikun e saj dhe prandaj, edhe vlerën e paqes. Le të kujtojmë se proceset e paqimit në Ballkan filluan më së shumti me paqimin e ushtrive sesa me marrëveshjet e politikanëve.

Serbët, jo vetëm sot, por sidomos më parë, e patën një ushtri qëndramijëshe, një nga ushtritë më të mëdha, në mos ushtrinë më të madhe e më të armatosur në Ballkan, për ta mbajtur Kosovën, sikur Kosova të ishte aq e shenjtë për ta. Por realisht nuk bënë asnjë përpjekje për ta mbajtur dhe nuk e mbajtën me gjak, pikërisht, sepse nuk ishte e tyre, edhe pse e mbajtën të pushtuar njëqind vjet.

emergjencat kombëtare, fatkeqësitë natyrore, kërkim-shpëtimi, mbrojtja e mjedisit, etj. Por këtotribute sigurie nuk kërcënojnë askënd, përveçse kontribuojnë edhe në sigurinë e fqinjëve e më gjerë.

Forca e Sigurisë e Kosovës - sot Ushtria e Kosovës, tregoi se diti e di të bëjë aleancë. Si ushtri çlirimtare bëri aleancë me NATO-n. Më pas, si Forcë e Sigurisë diti të bëjë aleancë me KFOR. Si e tillë, ajo demonstroi se di të marrë kulturë bashkëkohore ushtarake.

Nuk besoj se do t'u duhet më kultura e oficerëve të arsimuar në akademitë e Beogradit, kur tashmë ka mbi 15 vjet që punon me standardet e NATO-s. Do të jetë ushtria më e përparuar në këtë drejtim, jo vetëm nga profesionalizmi, por sidomos nga kuptimi i rolit të ushtrisë në një shoqëri demokratike. Prandaj, edhe për këtë arsye, do të jetë shumë më e pëlqyeshme të përfshihet gjithnjë e më shumë në sigurinë ndërkombëtare, në misionet paqeruajtëse dhe mbështetëse të paqes dhe në përgjigjet ndërkombëtare ndaj kërcënimeve transnacionale të sigurisë, si përhapja e armëve, terrorizmi dhe krimi i organizuar.

Është thënë se ushtarit dhe Zotit njerëzit iu drejtohen vetëm në kohë rreziku. Ndoshta është koha të vlerësohet se priten rreziqe. NATO nuk e ka më shkëlqimin e dikurshëm. As guximin e dikurshëm. Ndoshta do të duhet të rridimensionohet, e kjo kërkon kohë. E koha krijon vakum sigurie.

Sidoqoftë, Kosova ka filluar të respektojë vetveten. Me rritjen qind për qind të taksës për mallrat e importuara nga Serbia e tregoi këtë. Tashmë e tregoi edhe me ushtrinë e vet. Natyrisht është një hap sa i përgjegjshëm, aq edhe me përgjegjësi. Por sidoqoftë guxoi. Guxoi të jetë sovranë, përkundër skepticizmit që sundon aty brenda saj e, ku e ku, edhe jashtë saj.

Kosova po bëhet. Dhe ushtria e saj, siç thotë një francez i shquar, është një komb brenda kombit. Do bëhet edhe ajo.

Serbët, jo vetëm sot, por sidomos më parë, e patën një ushtri qëndramijëshe, një nga ushtritë më të mëdha, në mos ushtrinë më të madhe e më të armatosur në Ballkan, për ta mbajtur Kosovën, sikur Kosova të ishte aq e shenjtë për ta. Por realisht nuk bënë asnjë përpjekje për ta mbajtur dhe nuk e mbajtën me gjak, pikërisht, sepse nuk ishte e tyre, edhe pse e mbajtën të pushtuar njëqind vjet. Kosovën nuk e bëjnë të shenjtë manastiret e mbjella për qëllime pushtimi, por banorët më të vjetër shqiptarë që janë lindur aty prej shekujsh. Prandaj kosovarët ishin të gatshëm dhe derdhën gjak për ta çliruar, pikërisht, sepse Kosova është e kosovarëve, jo e ardhësve në Kosovë.

Krijimi i ushtrisë së Kosovës nuk është një rrezik, por një vonesë e pashembullt për të qenë të gatshëm për të përballuar rreziqet. Ishte mungesë vizioni e kapacitetesh apo shprehje frike? Sidoqoftë Kosova guxoi. Dhe guximi, çfarëdo guximi, mbart edhe rreziqe.

Dje në "New York Times"

Si do të jetë bota pas Trump-it?

Nga Ivan Krastev

(vijon nga faqja 1)

... dhe ju dilni që andej me një shije të keqe të vazhdueshme.

Kohët e fundit, qëndrova për 3 muaj në Uashington me ftesë të fondacionit "Henry A.Kissinger". Mesa duket, detyra ime ishte të arrija një kuptim të një bote që ishte e egër. Por, unë mendoj se gjatë kohës së qëndrimit tim atje, e vetmja gjë që arrita në realitet, ishte një konfuzion i një niveli të lartë.

Nuk qe vizita ime e parë në Amerikë, por kjo ishte më shqetësuesja. Ajo që e gjeta të ishte kaq shqetësuese, ishte polarizimi i përhapur politik që ka kaplur vendin. Është gjithashtu e qartë se Amerika është bërë më e mbyllur në vetvete dhe më e prirur të besojë në teoritë e konspiracionit.

Dhe në Uashington tani njerëzit nuk janë në gjendje të diskutojnë asgjë, përveç Presidentit Trump. Ata flasin për presidentin, edhe kur pretendojnë se flasin për diçka tjetër. Është gjithnjë Trump, gjatë gjithë kohës. Të vetmit njerëz që shmangin së foluri për Trump janë ata që punojnë për të.

Kur vizitoja dikur Uashingtonin, njerëzit në qeveri ishin të etur të flasin me mua, një analist, për gjithçka, që nga lufta në Ukrainë, deri te tregtia me Bashkimin Evropian. Ata donin që argumentet e tyre të dëgjoreshin në kontinent dhe donin mendimin e të huajve mbi ngjarjet botërore.

Por, zyrtarët në administratën "Trump" distancohen nga shumë njerëz - sidomos të huajt si unë. Ndoshta ata kanë frikë se ne mund të kuptojmë që edhe zyrtarët e lartë të Shtëpisë së Bardhë kanë shumë informacione në lidhje me atë që presidenti planifikon të bëjë në të ardhmen.

Megjithatë, ata që duan të flasin në emër të zotit Trump, e paraqesin politikën e jashtme jo-ortodokse, si të ngjashme me atë të Riçard Niksonit. Por ajo që unë nuk mund të kuptoj dot në këto biseda është se kush e luan këtë herë Henri Kissingerin.

Ndryshe nga zyrtarët qeveritarë, kritikët e presidentit në botën e think-tankeve dhe mediave duken të etur për të biseduar me evropianët. Kjo është një lloj psikanalize e pafundme, në të cilën nuk është e lehtë të kuptojmë se kush është pacienti dhe kush analisti.

Teksa takova dhjetëra njerëz të tillë përreth Uashingtonit, dëgjova të njëjtat gjëra: Trump është rastin më të mirë një president i pakicës; ai u zgjodh nga rusët; dhe në një farë pike (edhe pse jo shumë shpejt) do të largohet nga Shtëpia e Bardhë.

Pas kësaj bisede fshihet një ko-



mbinim i ankthit dhe shpresës - ankthi rreth asaj që zoti Trump ka shkatërruar dhe shpresës se sapo ai të jetë larguar nga detyra, çdo gjë do të rikthehet në normalitet. Kjo pjesë është e njohur. Një shpresë të ngjashme e kam ndeshur edhe në Evropë. Në shumicën e kryeqyteteve evropiane, politikëbërësit duan të besojnë se para se të jetë shumë vonë, Trump do të zhduket nga skena dhe rëndi botëror - duke përfshirë aleancat e ngushta midis Evropës dhe Shteteve të Bashkuara - do të rikthehet të jetë ai që ishte dikur.

Por ky është sekret i pistë që kam mësuar gjatë 3 muajve të qëndrimit tim në Uashington: Kjo nuk është e vërtetë. Bota nuk do të jetë më si dikur, edhe nëse demokratët do ta fitojnë Shtëpinë e Bardhë në vitin 2020. Dhe kjo jo thjesht sepse edhe nëse zoti Trump do të jetë larguar, në mbarë botën shumë nga liderët Trumpianë do të vazhdojnë të mbeten në pushtet.

Shumë nga ndryshimet që ka sjellë Trump në politikën e jashtme të Amerikës do të ekzistojnë edhe shumë kohë pasi ai të ketë lënë presidencën. Kur është fjala për rolin e Amerikës në botë, ai mund të përfundojë duke qenë më konsekuent sesa Xhorxh W.Bush apo Barak Obama.

Momenti Trump në fund mund t'i ngjajë momentit Truman, kur për një periudhë të shkurtër, Amerika ndryshoi në mënyrë dramatike pikëpamjet e saj mbi botën. Kjo mund të jetë një gjë e vështirë për t'u gëlltitur nga evropianët, por ky është mesazhi që po sjell me vete nga Uashingtoni.

Bota e post-Trumpiane nuk do të jetë bota para-Trumpit. Presidencën e zoti Trump ka sjellë dy ndryshime të rëndësishme, që kanë të ngjarë të jenë të qëndrueshme. Së pari, me administratën e tij amerikanët kanë humbur besimin në jashtëzakonshmërinë e tyre.

Nuk janë vetëm presidentët, por edhe brezi i mijëvjeçarit (të cilët kryesisht e kundërshtojnë), që nuk ndajnë besimin se Amerika është një "komb i domosdoshëm" dhe me një detyrim moral për ta bërë botën të sigurt për demokracinë. Dallimi është se ndërsa brezi i ri beson se Amerika vështirë se është më e mirë se sa vendet e tjera, Trump beson se nëse Amerika dëshiron të mbrojë udhëheqjen e saj globale, ajo duhet të jetë më e mirë se të tjerat.

Së dyti, nën presidencën Trump, rivaliteti me Kinën është bërë parimi organizues i politikës së jashtme amerikane. Republikanët dhe demokratët nuk pajtohen mbi gati asgjë sot. Por një fushë ku duket se ka konsensus mes tyre është se Amerika duhet të ndryshojë politikën e saj ndaj Kinës.

Vetëm disa shpirtëra të humbur në Uashington vazhdojnë të besojnë se zhvillimi ekonomik i Kinës do të çojë në një hapje politike. Tani ekziston një konsensus, se lejimi i Kinës për t'u bashkuar Organizatës Botërore të Tregtisë në vitin 2001 ishte një gabim dhe se në qoftë se Ameri-

ka nuk arrin ta frenojë tani ekspansionin gjeopolitik të Kinës, nesër do të jetë e pamundur ta bëjë këtë.

Sipas mendimit tim, ankthi i Amerikës në lidhje me Kinën është kuptimi i faktit se autoritarizmi i të dhënave të mëdha dhe miqësor ndaj tregtisë i Kinës është një kundërshtar shumë më i rrezikshëm për demokracitë liberale sesa komunizmi sovjetik.

Është e zakonshme të dëgjosh sot evropianët të shfaqin nostalgji për Luftën e Ftohtë, një kohë kur Shtetet e Bashkuara dhe Evropa Perëndimore u bashkuar në një aleancë kundër Bashkimit Sovjetik. Por, amerikanët nuk e ndajnë këtë nostalgji. Ata po kërkojnë aleatë të rreshtuar kundër Kinës.

Dhe përplasja me Pekinin nuk është diçka për të cilën janë të interesuar shumica e evropianëve. Do të ishte një tragjedi dhe më keq akoma një gabim, nëse evropianët nuk do të arrijnë ta kuptojnë se marrëdhëniet e tyre me Shtetet e Bashkuara do të përcaktohen nga Kina, jo vetëm tani, por edhe pasi zoti Trump të kenë lënë detyrën që mban.

Dhe që Evropa të ketë një qëndrim të qartë në përplasjen e ardhshme midis Uashingtonit dhe Pekinit, do të jetë shumë më e dhimbshme sesa të shkosh tek dentisti.

Ivan Krastev është kryetar i Qendrës për Strategjitë Liberale, anëtar i Institutit për Shkencat Humane në Vjenë dhe autori i librit më të fundit "Pas Evropës".

HOROSKOPI

DASHI

Edhe nëse dikush mund të duket i këndshëm dhe simpatik mund të ketë qëllime devijuese. Mos lejoni veten që të besoni te njerëzit vetëm për shkak se duken të besueshëm, por bazohuni te faktet.

DEMI

Kujdes nga njerëzit që përdorin joshjen për të marrë atë që duan. Ju mund të gjeni veten duke konkurruar me dikë, flirtimi i të cilëve merr më shumë pikë sesa idetë tuaja të arsyetara mirë.

BINJAKET

Ju duhet të merrni këshillën e miqve tuaj, të afërme ose bashkëpunëtorëve tuaj më të afërt - edhe nëse kjo do të thotë të pranosh humbjen. Është në rregull të kërkonin ndihmë dhe të lejoni njerëzit e tjerë t'ju ndihmojnë kur është e nevojshme.

GAFORJA

Nëse shoqëroheni me njerëzit me të cilët jeni i lidhur, mund të gjeni gjëra të reja që do ju surprizojnë. Një darkë e rastësishme mund të jetë rasti i duhur për të mbledhur së bashku miqtë dhe familjen.

LUANI

A jeni të pakënaqur me karrierën tuaj? Është koha për të përdorur zgjuarsinë tuaj për disa mundësi të reja. Në sferën e dashurisë, topi është në fushën tuaj. Mos u dorëzoni vetëm sepse urrëni që të humbni.

VIRGJERESHA

Dikush me të cilin shpesh nuk jeni dakord do t'i shohë gjërat në mënyrën tuaj sot. Në fakt, ai ose ajo madje mund të hidhet në mbrojtjen tuaj dhe t'ju ndihmojnë të fitoni një debat të ndezur - edhe pse argëtues.

PESHORJA

Sot do të mbusheni me një dozë të madhe energjie të bukur magnetike sot. Edhe mes një turme, ju do të jeni në gjendje të tërheqni njerëz rreth jush në një mënyrë të jashtëzakonshme.

AKREPI

Duke lejuar njerëzit që të mbështeten te ju është një nga mënyrat më të mira për të vërtetuar besnikërinë tuaj si një mik. Sot dëshira juaj për të ndihmuar të tjerët do t'ju çojë drejt një personi special.

SHIGJETARI

Me gjithë energjinë mashkullore që është në jetën tuaj tani, do të ndihni shumë e sfiduar. Çdo gjë do të ndjehet si një konkurs për ju. Por ju mund ta konsideroni këtë si diçka argëtuese.

BRICJAPI

Kur vjen puna për të balancuar jetën tuaj personale me karrierën, ju jeni duke bërë një punë të mrekullueshme. Ju keni aftësi të shkëlqyera komunikimi për të cilën duhet të falënderoheni.

UJORI

Jeni gati për ide dhe koncepte të përparura. Nëse i sfidoni aftësitë tuaja mendore, ju do të merrni një nxitje të fortë në lidhje me egon tuaj. Sukseset tuaja do të jenë të menduarit. Kur dikush ju përcjell informacione personale sot, ai ose ajo jo domosdoshmërisht dëshiron që ju të përgjigjeni.

PESHQIT

Sic jeni në djepin, komunikimi përfshin më shumë se sa thjesht të folurën dhe dëgjuarin. Tani, ju duhet të punoni në aftësitë tuaja të të menduarit. Kur dikush ju përcjell informacione personale sot, ai ose ajo jo domosdoshmërisht dëshiron që ju të përgjigjeni.

LISTA E ZEZË E ZIKALTËRVE

Me të skarcuarit nuk mund të përmirësohesh", janë këto fjalët e Luciano Spaletit pas konferencës për shtyp në përfundim të ndeshjes me Kievon. Historia zikaltrë e kohëve të fundit ka treguar në disa raste se trajneri aktual mund të ketë të drejtë. Blerja e parë dimërore e epokës "Spalet" i ishte Lisandro Lopez. Qendërmbrojtësi luajti 45 minuta në



6 muaj zikaltrë, me trajnerin që preferonte të aktivizonte në qendër Santon vetëm për të

Nga Batistuta te Shaqiri, ja dështimet e Interit në merkato

mos rrezikuar me portugezin. Edhe Podolski nuk pati fat më të mirë. I ardhur si kampion bote, realizoi vetëm 1 gol në 17 ndeshje me zikaltrit. Forma e dobët dhe kontributi i pakët bënë që të mos ndihej shitja e tij. Jashtë forme edhe Xherdan Shaqiri në formatin milanëz. Ylli aktual i Liverpoolit me

Interin shënoi vetëm tre gola, mbase pak, por që shërbyen për të bindur Stoken ta blinte. 52 ndeshje dhe 7 gola për Hernanesin me Interin. I ardhur në janar edhe ai ishte një burim pritshmërisht që kurrë nuk u respektuan. Santon u rikthye tek Interi me kërkesë të Mançinit. Mbrojtësi nuk

shkëlqeu kurrë deri në verën e kaluar që kaloi te Roma. I njëjti fat për dy bomberat, Gabriel Batistuta e Tomaso Roki. Të ardhur respektivisht në janar të 2003-sht dhe të 2015, asnjëri syresh nuk la shenjë me fanellë zikaltrë, ndryshe nga Tren Seinsburi. Australiani u stërvit në "Pinettina" dhe pas kalimit te PSV-ja, disa javë më pas u hakmor me një barazim që i kushtoi Interit eliminimin nga Champions-i.

Ditë e ngarkuar dje te verilindorët, që u përfshinë në zëra të ndryshëm merkatoje



Jeton Selimi

Kukësi: Rexhinaldo sikën, Zguro i urojmë suksese!

Qëndron sulmuesi afrikan, largohet mbrojtësi

Nënkampionët e Shqipërisë janë treguar tepër aktivë si në hyrje ku kanë afruar dy lojtarë mjaft të mirë si Rroca e Shkurtaç, gjithashtu, dhe në dalje. Mbas largimeve të Shpehar, e Zguro tashmë i larguari i radhës është ish-lojtari i Juventus U20, Ture, por duket se "skarcimet" duket se do të vazhdojnë. Një postim i brazilianit Melon në "Instagram" ka ngjallur dyshime të forta për sa i përket të ardhmes të sulmuesit nga Mozambiku, Rexhinaldo. Mbrojtësi i Kukësit ka publikuar një foto me Rexhinaldon, duke i bashkangjitur edhe një mesazh "lamtumire". "Shumë mirënjohje për miqësinë tonë vëlla, faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua. Do të jesh një shok që do të mbaj për gjithë jetën. Gjithnjë do të jemi në kontakt", shkruan Melo. Ky postim ka ngjallur shumë aludime dhe mediat natyrisht që kanë hamendësuar largimin e mozambikasit nga nënkampionët. Por vetë klubi ka reaguar në lidhje me këtë çështje, duke sqaruar në profilin e tyre zyrtar në "Facebook" se Rexhinaldo është i padiskutueshëm dhe që nuk do të largohet. "Duke marrë shkas nga spekulimet e bëra në media për futbol-



listin Reginaldo Fait, dëshirojmë të informojmë të gjithë tifozët, por edhe sportdashësit në tërësi, se mozambikasi është pjesë e padiskutueshme e skuadrës sonë. Sulmuesi është nën kontratë me Futboll Klub Kukësin deri në fund të se-

zonit futbollistik. Drejtuesit e Klubit e shohin 28-vjeçarin të denjë për projektin e ekipit tonë, i cili synon fitimin titullit Kampion, Kupën e Shqipërisë, Superkupën si dhe përfaqësimin në mënyrë dinjitoze në Kupat e Europës."

LARGOHET ZGURO
Por, nëse për Rexhinaldon Kukësi ka njoftuar qëndrimin, për lojtarë të tjerë ndryshon situata. Gjatë ditës së diel, u largua Dino Shpehar ndërkohë që dje ka qenë radha e një tjetër futbollisti për t'u larguar. Bëhet fjalë

për mbrojtësin pogradecar Vangjel Zguro, i cili ka qenë një pjesë e rëndësishme e formacionit verilindor këtë sezon, duke zënë vendin e Simon Rrumbullakut të dëmtuar. Megjithatë, skema që po përdoret nga Chungu me 3 mbrojtës, e ka lënë jashtë planeve mbrojtësin Zguro dhe kështu, është vendosur që ai të largohet. Lajmi bëhet i ditur nga vetë faqja zyrtare e klubit verilindor në rrjetin social "Facebook". "Futboll Klub Kukësi zyrtarizon mbylljen e bashkëpunimit me Vangjel Zguron. Pogradecari ka ndërprerë me mirëkuptim marrëveshjen me Kukësin. Mëngjarashi, i cili u bashkua me ekipin tonë gjatë merkatos së verës, regjistroi 16 aktivizime në të gjitha kompeticionet. Klubi falënderon Vangjel Zguron për kontributin e dhënë me fanellën tonë dhe njëkohësisht i uron suksese në karrierë", shkruhej në njoftimin e Kukësit.

Barcelona mendon për pasuesin e Suarezit

Luis Suarez është në përfundim të kontratës dhe duket se Barcelona po përpiqet tashmë të gjejë zëvendësuesin e tij. Një tjetër uruguaijan për reparatën ofensiv. Maksim Gomez është lojtari 22-vjeçar i Selta Vigos dhe po mahnit me paraqitjet e tij, aq sa ka bindur edhe përfaqësuesit e ekipit katalanas që t'i ofrojnë një kontratë sulmuesit. Gomez ka kontratë deri në vitin 2022 me Seltën dhe për të është e interesuar edhe ekipi i Atletikos së Madridit. Shuma që Barcelona do të duhet të pagojë për ta transferuar në "Camp Nou" është rreth 40 milionë euro.

Runi: Me Murinjon nuk ishin të lumtur as kuzhinierët

Uejn Runi ka folur për mikrofonet e "BT Sport" në lidhje me situatën te Mançester Junajtid, konkretisht për largimin e trajnerit portugez Zhoze Mourinjo. Ai ka bërë edhe pak humor: "Jam i sigurt se Ed Vudard mendonte të njëjtat gjëra që mendonin të gjithë nëpunësit e klubit të Mançesterit. Edhe kuzhinierët dhe magazinierët nuk ishin të lumtur me trajnerin Mourinjo. Për të fituar në futboll duhet që gjithçka të jetë e drejtë dhe që të gjithë të jenë të lumtur. Tani futbollistët po buzëqeshin sërish dhe do të jetë interesante të shohim Sol-skjaerin si e rreshton skuadrën në fushë", - ka thënë ish-sulmuesi i Mançester Junajtid.

Francezët duan përforcime

PSG bën pazar në Napoli, pëlqehen Alan dhe Zielinski

Drejtuesit e PSG-së janë dashuruar me dy nga futbollistët titullarë të Napoli, me të cilin ishin në të njëjtin grup në Champions League. "Tuttosport" bën me dije se klubi i njohur francez i ka hedhur sytë te dy mesfushorët Alan dhe Zielinski. Objektivi i parë i PSG-së është braziliani Alan, por edhe polaku pëlqehet shumë. PSG-ja ka nevojë për elemente cilësorë në qendrën e mesfushës, ku ka pasur mungesë alternativash pas largimit të Lo Selsos dhe acarimit të marrëdhënieve me Rabiot.



Napoli nuk ka në plan të privohet nga dy prej futbollistëve më të mirë dhe kërkon që t'i bindojë sa më shpejt, si Alan ashtu edhe Zielinskin, por oferta e PSG-së mund të jetë joshëse dhe presidenti De Laurentiis mund të tundohet. Emri te PSG-ja i ka dalë edhe Elseid Hysaj, por realisht nuk ka pasur diçka konkrete për futbollistin e kombëtares kuqezi.

ZGJIDHJA E TRAJNERIT

Sarri bën gati një psikolog për Çelsin


Çelsi i fillimit të sezonit duket një kujtim i bukur. Në tri javët e fundit skuadra nuk ka mundur të fitojë dhe humbja në shtëpi me Leicesterin ka sjellë jo pak zhgënjim. Blutë kanë shkuar 11 pikë pas Liverpoolit, duke e shuar që tani ëndërrin e titullit. Për të kapërcyer situatën, trajneri Sarri ka menduar një zgjidhje origjinale. "Sun" bën me dije se trajneri italian ka kërkuar një psikolog që t'i sjellë lojtarët në vete, sepse sipas tij, humbjet nuk kanë ardhur për shkak të taktikave dhe fizike: "Kam pasur një psikolog



sportiv 15 vjet më parë në Itali, por ishte e vështirë, sepse klubet nuk ishin gati atëherë. Tani mund të flasim. Nuk

kemi humbur për shkak të fizike. Të shtunën ishin shumë mirë në fushë për 55 minuta, por pasi pësuam golin ishim në telashe. Prandaj mendoj se ka një arsye tjetër për këtë krizë", - ka thënë Sarri. Reagimi i skuadrës pas golit të Vardit e ka lënë të shtangur edhe vetë trajnerin italian. "Ishim konfuzë mendërisht. Duhet të luanim si në fillim", - ka shtuar Sarri. Është e qartë që trajneri kërkon ta zgjidhë problemin para se të jetë vonë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Salacrou dramaturg
6. Blair e Ekzorcistit.
9. I bylyllit ai i Mjedës.
10. Inicialet e Morricones
12. Gjysmë vektor.
13. Një port përballë Xhibutit.
14. Në mes të Salt dhe City.
16. Janë stacionet e beduinëve.
19. Një pjesë e taktikës.
20. Janë tifozë partie.
22. Janë firmat mashtruese.
23. Përpunojnë naftë.
27. Janë konservatorë.
28. Eshhtë derri.
30. Një monedhë magedonase.
31. Kufizojnë ambiente.
33. Inicialet e Gould aktor.
34. Fillojnë jetën.
36. Janë dëshmorët.

39. U shkrua nga Garcia Lorca.
44. Janë baballarët.
45. Tregon çmimin dhe modelin.
47. Eshhtë ujëvara.
48. Një mund të jetë mbi xhiro.

VERTIKAL

1. Film i James Cameron.
2. Jeronim de i Milosaos.
3. Eshhtë doktori me bluzë të bardhë.
4. Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
5. Janë si jerm.
6. Fillojnë lejen.
7. Klikohet me mouse
8. Një vegël.
11. Luftohet me kinina.
12. Janë cilësi.
15. Janë reaksionet në epruveta
17. Një sportist që kërcen me shkop.
18. Janë tek në zhele
20. Eshhtë kullë xhamie.
21. Bëhet një për zakon.
22. Gruaja e Fantozzi-t
24. Gjysmë afërsi.
25. Janë ndriçues.
26. Nuk duhet shkelur një i tillë.
29. U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
30. Një fjalë për gjoja.
32. Garbo e kinemasë.
35. Braktisi Didonën.
36. Me të bëjnë një thikë.
37. Mund të jetë gjaku.
38. Janë dhoma.
40. Ai dhe ajo.
41. Ushtria republikane irlandeze.
42. Agjenci Transporti Korçë.
43. Me stpon në box.
46. Inicialet e Moravia-s.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Ishite babai i parë.
6. I ndërmarrt progresistët.
14. Thmyhet një me kohën më të mirë.
16. U braktis nga Helena.
17. Seritë pa ze.
18. Kryeqyteti i Kinës.
20. Ramazoziti këngëtar.
21. Eshhtë sport me vozitje.
25. Ndërmarre Industriale Rajonale.
26. Janë sherre në shtyp.
27. Inicialet e Clapton.
28. Eshhtë shuma e brinjëve të drejtëndëshit.
30. Një letrar është tregimi.
32. Fillojnë nazet.
33. Matet pa kufij.
36. Inicialet e Kokoschka piktor
37. Kufiojnë mendimet.
38. Bergman që qe aktore.


40. Eshhtë shpërbimi në para.
44. Eshhtë i keq.
45. Mund të kthehet në mlllef.
46. Një pije piratësh.
48. Janë në fazë.
49. Fillojnë lejen.
50. U shkrua nga Theodore Dreiser.
53. Një... italiane.
54. Një verë në Paris.
55. Janë vende ku prehehen martirë.
56. Italia në Internet

VERTIKAL


1. Wenger trainer.
2. Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
3. Një është edhe Bujar Lako
4. Fillojnë mobilizimin.
5. Institucione Rajonale Polake.
7. Një rapper i famshëm.
8. Kështu thirrej Ronaldo, bombieri brazilian
9. Ndezur në aparaturë.
10. Një film i ribërë.
11. Ekstreme në model.
12. Dy asa.
13. Eshhtë fytyra kamionit.
15. Mund të bëhet me medalje trimërie.
19. Mund të jenë të rastit.
22. E ka simbolin TI.
23. Eshhtë dëm, qeder.
24. Inicialet e Tappert.
26. Një pjesë e pejsazhit.
28. Ndahet në barazim.
29. Janë kandilë deti
31. Hayërth që qe aktore
34. Eshhtë enë për të skuqur.
35. Emri i Zola.
39. Gjysma e globit.
41. Janë në skaje.
42. Kryqyteti i Letonisë.
43. Eva... Isabeli Allende-s
47. Një stacion i famshëm orbital
51. Inicialet e Lennon.
52. Diftong në duet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5		8		6	4			3	
	6	1	3						9
2		3		9				4	
1	2	5		7		3			
8		9				6		4	
				3	8	1	5		
	1		5		9	4			7
									5
9		6			2	8			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	3	7	8	5	1	4	6	2
6	8	4	2	7	3	5	9	1
2	1	5	4	9	6	7	3	8
7	5	8	6	2	4	9	1	3
3	6	2	5	1	9	8	7	4
4	9	1	7	3	8	6	2	5
5	4	3	9	6	2	1	8	7
1	7	9	3	8	5	2	4	6
8	2	6	1	4	7	3	5	9

Argëtim filozofik

- Do të më shihni dhe do thuash: kam humbur gjithçka...
Do të shoh dhe do them: gjynah për kohën e humbur !!!

- Nëse sot nuk e vlerësojnë praninë tuaj, nesër do të ndjenë mungesën tuaj !!!

- Nuk ka nevojë të kesh një shans të dytë për të krijuar përshtypjen e parë, dhe mos harroni se vetëm përshtypja e parë mund të të japë një shans të dytë !!!

- Shumë herë varfëria e njerëzve nuk është në xhepat e tyre ... por në shpirtin e tyre !!!

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	5	15	8	P	F	A	3	11	11	15	9	14	3	B	A	S	T	E	T	P	A	P	A		
2	8	2	9	2	6	15	9	2		17	11			U	R	A	T	U	R	H	P	A			
6		6	5	8	2	6		8	2	8	2	14		S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I	
	11	4	12	2	7		6	2	11	2		3		T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
8	2	9	4	6	3		6	9	15	9	3			P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T
	9	8		3	2	12		4	7	3	2	14		G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R	
4	6	2	6			4		6	3	14	17			B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T	
8	5	13	19		4	9	3			3	15	6		S	A	L	I	R	A	M	A	E			
3	7		6	19	12	3		4	12		11	4		G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R	
6	3	9	2	13	4	6		9	3	12	2	6		A	R	E	S	A	O	E	N	E			
4	13		6	3	6	2	13	3	11	4		4		Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T	
6	2	15		4	9			11	15	9	2	6		I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S	

- Mos provokoni heshtjen e një njeriu ... sepse nuk do të jeni në gjendje të duroni fjalët që ai ka për të të thënë !!!
- Nëna është si qiri, që djeg veten për të ndriçuar jetën tonë !!!
- Gjithmonë kur dikja vjen papritur në jetën tuaj, ikën në të njëjtën mënyrë !!!

- Jeta nuk ju jep kurrë siguri ... ju jep vetëm mundësi !!!
- "Fal" ... sepse një ditë ju do të keni nevojë për një falje !!!
- Mos trokit në derën e dikujt që e hap atë për të gjithë ... sepse miku i të gjithëve nuk është miku i askujt !!!

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik



MAK ALBANIA HOTEL

31 Dhjetor 2018

20:30



PJESË E
KASTRATI GROUP



MAK ALBANIA HOTEL

Nata e ndërrimit të viteve!

- ~ Menu me 7 raunde dhe pije të përfshira
- ~ Muzikë dhe Argëtim Live nga këngëtarët Altin Goci, Marsela Çibukaj, grupi Ali Pashe Tepelena dhe cirku i Tiranës
- ~ Gëzuar Vitin e Ri me "Moët Chandon" dhe fishekzjarre në tarracën e Infinity Bar
- ~ Shorte me dhurata



**Për prenotime deri me datë 20 Dhjetor, për cdo 6 persona i 7-i falas
Ofertë speciale akomodimi për muajin Dhjetor 75 euro çifti**

Terma dhe kushte

Menu speciale për fëmijë me 50% zbritje për moshën 5-12 vjeç
Fëmijët 0-5 vjeç falas
Parkim i garantuar pa pagesë



+355 4 2274 707



+355 69 20 25205



sales.tirana@makalbania.com

